

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ



MËSIME NGA SURET E SHKURTRA TË KUR'ANIT

Tiranë, 2024

Titulli i librit: Mësime nga suret e shkurtra të Kur'anit

E përgatiti: Haxhi Shejkh Vullnet MERJA

Redaktoi: Prof. Dr. Hajri SHEHU

Korrektoi: Vjollca KARAJ

Përkujdesja kompjuterike & kopertina: Sabrie FEZA

Botoi: "Fondacioni i Kur'anit"

Adresa: Rr. Musa Vathi, ndërtesa nr. 3, hyrja 1. Kutia Postare: 8272

Web: www.fqurani.org & e_mail: quranfondation114@gmail.com

Tirana - Albania

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit,
Mëshirëplotit!

FJALA E BOTUESIT

Dobitë e studimit të Kur'anit

Kur'ani i Shenjtë është baza e fesë dhe porta për të hyrë në Islam. Ai është Libri i Allahut. Allahu, i Plotfuqishmi, i Gjithëdituri, i Urti ka vendosur të vërtetat e fesë së Tij të fundit e të pastër, Islamit. Allahu na urdhëron që të kapemi fort pas Kur'anit dhe ta zbatojmë atë fort në jetën tonë të përditshme. Allahu e ka zbritur Kur'anin udhërrëfyes dhe ndriçues për mbarë njerëzimin. E ka zbritur që t'i nxjerrë njerëzit nga errësirat në dritë.

Allahu i Madhëruar thotë:

وَهَذَا كِتَابٌ أَنْزَلْنَاهُ مُبَارَكٌ فَاتَّبِعُوهُ وَاتَّقُوا لَعَلَّكُمْ تُرْحَمُونَ

“Ky Libër që kemi shpallur, është i bekuar. Prandaj ndiqeni dhe druajuni kundërshtimit, në mënyrë që të mëshiroheni.”¹

Nuk vjen libër tjetër nga Allahu pas Kur'anit. Ai është këshillë, shërim dhe mëshirë. Është dritë dhe udhëzim. Kushdo që dëshiron të mbërrijë sa më afër Krijuesit të tij, duhet të ketë Kur'anin prijës në jetën e vet.

Profeti Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Nëse dëshironi jetesën e të lumturve, vdekjen e dëshmorëve, shpëtimin në Ditën e vështrësisë, hijëzimin në Ditën e nxehtë dhe udhëzimin në Ditën e humbjes, studiojeni Kur'anin sepse ai është Fjala e Rahmanit (të Gjithëmëshirmit), mbrojtja prej djallit dhe drejtuesi për nga veprat e mira në peshore.”²

E kanë pyetur Imam Rizain (*Paqja qoftë mbi të!*): Çfarë thua për Kur'anin? Ai ka thënë: “Është fjala e Allahut. Mos dilni para tij! Mos kërkoni udhëzim prej tjetër kujt përveçse prej tij se do të humbisni!”³

Kur'ani është përsosuria e vërtetë. Cilido që e mëson Kur'anin dhe e bën pjesë të qenies së vet, sigurisht që mbart një mirësi të madhe dhe pasuri të pashtershme. Kur'ani

¹ Sure “En'am”, ajeti 155.

² “Mustedrekul Uesail”, vëllimi 4, faqe 232.

³ “Biharul Anur”, vëllimi 89, faqe 117.

është tryeza e Allahut për njerëzit. Ai e ka zbukuruar këtë tryezë me llojet më të përsosura e të panumërta të ushqimeve për dijen dhe shpirtin. Në këtë tryezë gjendet çdo gjë për të cilën kanë nevojë njerëzit. Allahu i Madhëruar thotë: **“Vërtet, Ne u kemi sjellë njerëzve shembuj në këtë Kur’an për çdo gjë, për t’ua vënë veshin.”**⁴

Profeti Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: *“Sigurisht, ky Kur’an është tryeza e Allahut, prandaj, studiojeni sa të mundeni tryezën e Tij.”*⁵

Kur’ani është depozita e dijeve të Allahut. Ai që ndriçohet me këtë dije dhe i bën të vetat ato, do të jetë prej banorëve të Xhenetit. Profeti Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: *“Mbartësit e Kur’anit janë të diturit e banorëve të Xhenetit.”*⁶

Transmetohet nga imam Sexhxhadi (*Paqja qoftë mbi të!*) se ka thënë: *“Ajetet e Kur’anit janë depozitat e dijes. Sa herë që të hapësh një depozitë, ti duhet të shikosh se çfarë ka në të.”*⁷

⁴ Sure “Zumer”, ajeti 27.

⁵ “Mustedrekul Uesail”, vëllimi 4, faqe 232.

⁶ “Mustedrekul Uesail”, vëllimi 4, faqe 243.

⁷ “Mustedrekul Uesail”, vëllimi 4, faqe 238.

Ndikimet dobiprurëse të Kur'anit

Cilido që e studion Kur'anin, do të shohë ndikime të këndshme e dobiprurëse. Disa prej tyre janë:

1- NJOHJA E ALLAHUT

Kjo çështje, e cila është themeli dhe baza e besimit të drejtë islam, përfshin një pjesë të madhe të Kur'anit të Shenjtë dhe përmendet në forma të ndryshme. Njohja e Allahut është detyrë e të gjithë njerëzve. Kur'ani i Shenjtë e përmend dhe e sqaron në disa ajete të tij çështjen e njohjes së Allahut të Madhëruar. Allahu thotë në Kur'an: **“Nëse ti (o Muhamed) i pyet ata: ‘Kush i ka krijuar qiejt dhe Tokën?’, me siguri që do të të thonë: ‘Allahu.’ Atëherë ti thuaju: ‘Qoftë lavdëruar Allahu!’ Por, shumica e tyre nuk dinë.”**⁸

Problemi është se njerëzit nuk e njohin Krijuesin e tyre ashtu siç duhet njohur dhe nuk e vlerësojnë Krijuesin ashtu siç e meriton Ai. Dhe, si pasojë, ata nuk besojnë dhe nuk e adhurojnë Atë. Këtë e dëshmon edhe Kur'ani i Shenjtë: **“Ata nuk e vlerësojnë siç duhet Allahun...”**⁹

⁸ Sure “Lukman”, ajeti 25.

⁹ Sure “En'am”, ajeti 91.

Transmetohet se Profeti Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Nëse do ta njihnit Allahun ashtu siç e meriton Ai njohjen, edhe malet e larta e të patundshme do të zhduken me lutjen tuaj...”¹⁰

Sigurisht, njohja e Allahut arrihet duke medituar thellë për krijimet e Tij dhe për mirësitë e shumta, me të cilat Ai i ka bekuar krijesat e Tij. Njohja e Allahut arrihet duke menduar thellë për sistemin e krijimit të universit me saktësi të lartë e të mahnitshme nga Allahu i Plotfuqishëm. Allahu i Madhëruar thotë: **“Ti i shikon malet e mendon se janë të palëvizshme, por ato lëvizin si retë. E tillë është fuqia e Allahut, i Cili ka përsosur çdo gjë. Ai di mirë çdo gjë që bëni ju.”**¹¹

Prej argumenteve të njohjes së Allahut, që i përmend Kur’ani i Shenjtë, është krijimi i qiejve e i Tokës dhe i gjithçkaje që ndodhet në to, ndryshimi i natës dhe i ditës, ndryshimi i gjuhëve, i ngjyrave etj.

Allahu i Madhëruar thotë: **“Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të Tokës, në këmbimin e natës me ditën, në anijet që lundrojnë nëpër det për t’u sjellë dobi njerëzve, në ujin që Allahu zbret prej qiellit, duke ngjallur përmes tij tokën e vdekur dhe duke shpërndarë gjithfarë gjallesash, në lëvizjen e erërave dhe në retë që**

¹⁰ “Auali Leali”, vëllimi 4, faqe 132.

¹¹ Sure “Neml”, ajeti 88.

qëndrojnë midis qiellit e Tokës, pra, në të gjitha këto, sigurisht që ka Shenja për njerëzit me intelekt.”¹²

Dhe: “Vërtet, në ndërrimin e natës me ditën dhe në atë që ka krijuar Allahu në qiej dhe në Tokë, ka Shenja për njerëzit që i frikësohen Allahut.”¹³

Dhe: “Ndërmjet Shenjave të Tij janë krijimi i qiejve e i Tokës dhe shumëllojshmëria e gjuhëve dhe e ngjyrave (racave) tuaja. Pa dyshim, në këtë ka Shenja për ata që dinë.”¹⁴

Dhe: “Të tjera Shenja të Tij janë gjumi juaj natën e ditën dhe kërkesa e juaj nga dhuntitë e Tij. Vërtet, në këtë ka Shenja për njerëzit që dëgjojnë.”¹⁵

Dhe: “Gjithashtu, prej Shenjave të Tij janë paraqitja e vetëtimës si frikë e shpresë dhe dërgimi i shiut prej qiellit, që nëpërmjet tij të gjallërohet toka pas shkretimit të saj. Sigurisht, në këtë ka Shenja për njerëzit që mendojnë.”¹⁶

Pasi Allahu sjell argumentet që vërtojnë se Ai është Krijuesi i gjithçkaje dhe Sunduesi Fuqiplotë, i fton mohuesit

¹² Sure “Bekare”, ajeti 164.

¹³ Sure “Junus”, ajeti 6.

¹⁴ Sure “Rrum”, ajeti 22.

¹⁵ Sure “Rrum”, ajeti 23.

¹⁶ Sure “Rrum”, ajeti 24.

që të sjellin argumentet e tyre nëse janë të vërtetë në mohimin e tyre. Allahu thotë: **“...atëherë sillni provën tuaj!”**¹⁷ Vërtet, kjo është një sfidë për të gjithë mohuesit dhe jobesimtarët e çdo kohe dhe të çdo vendi.

Kur’ani i Shenjtë fton në *Teuhijd* (*Teuhijdi* është besimi se Zoti është Një, i Vetëm e i Pashoq). *Teuhijdi* është në përputhje me Qenien e Tij, Atributet e Tij dhe me Veprat e Tij. Allahu thotë: **“Ai është Allahu, përveç të Cilit nuk ka Zot tjetër** (të denjë për adhurim). **Ai është Njohësi i së dukshmes dhe i së padukshmes. Ai është i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti. Ai është Allahu, përveç të Cilit nuk ka zot tjetër** (të denjë për adhurim). **Ai është Sunduesi, i Shenjti** (i pastër nga çdo e metë), **Paqedhënësi, Dhënësi i sigurisë, Mbikëqyrësi mbi gjithçka, i Plotfuqishmi, Imponuesi, Madhështori. Qoftë i lartësuar Allahu mbi gjithçka që ia shoqërojnë Atij** (në adhurim)! **Ai është Allahu, Krijuesi, Zanafillësi, Ai që çdo gjëje i jep trajtë. Atij i përkasin Emrat më të bukur; Atë e përlëvdon gjithçka që ndodhet në qiej dhe në Tokë, Ai është i Plotfuqishmi dhe i Urti.”**¹⁸

Kjo është ftesa e Kur’anit për të gjithë njerëzimin. Cilido që e lexon Kur’anin do të mësojë se ai përdor dy gjuhë për përcjelljen e mesazheve të tij: - gjuhën e logjikës dhe

¹⁷ Sure “Bekare”, ajeti 111.

¹⁸ Sure “Hashr”, ajetet 22-24.

gjuhën e zemrës. Kur'ani e konsideron logjikën argument për njerëzit dhe i fton që ta vënë në funksion dhe përfitojnë prej saj. Njëherësh, Kur'ani i qorton ata që nuk e përdorin logjikën e tyre dhe as që udhëzohen me anë të saj. Allahu i Madhëruar thotë në Kur'an: **“Krijesat më të këqija para Allahut janë ato që janë shurdhe dhe memece (ndaj së Vërtetës) e që nuk kanë arsye.”**¹⁹

Po ashtu, Kur'ani i Shenjtë përmend edhe pengesat që e pengojnë njohjen e të vërtetave, në krye të cilave qëndron njohja e Allahut të Madhëruar. Prej atyre janë:

1- Ndjekja e hamendësimit. Kur'ani thotë: **“Ata ndjekin vetëm hamendjet dhe atë që ua ka dëshira...”**²⁰

2- Imitimi etërve. Kur'ani thotë: **“Kur atyre u thuhet: ‘Ndiqni atë që ka shpallur Allahu!’, ata përgjigjen: ‘Jo! Ne do të ndjekim atë udhë, në të cilën i kemi gjetur të parët tanë.’ Vallë, edhe atëherë kur të parët e tyre nuk kuptonin gjë e nuk ishin të udhëzuar?!”**²¹

3- Ndjekja e egos. Allahu thotë në Kur'an: **“A e ke parë ti atë që e pshin e vet e ka marrë për zot? A do t'i bëhesh mbrojtës atij?!”** (Sure “Furkan”, ajeti 43.)

¹⁹ Sure “Enfal”, ajeti 22.

²⁰ Sure “Nexhm”, ajeti 23.

²¹ Sure “Bekare”, ajeti 170.

Sa shumë ka të tillë njerëz sot në ditët tona! Kjo fatkeqësi është edhe në mesin e myslimanëve. Me keqardhje themi: Janë larguar nga Fjala e Allahut të Madhëruar.

Kur'ani e fton njeriun në besim, mbështetur në argumente të shumta logjike. Ai i drejtohet natyrës së pastër të njeriut, që gjithmonë të jetë e drejtuar kah Krijuesi i gjithësisë, Allahu i Plotfuqishëm.

Allahu thotë në Kur'an: **“A ka më të mirë se Ai që e ka bërë Tokën të qëndrueshme, ka bërë në të lumenj, ka ngritur në të male dhe ka bërë midis dy deteve pengesë të padukshme? Vallë, a ka krahas Allahut, zot tjetër? Jo. Por shumica e tyre janë të paditur. A ka më të mirë se Ai që i vjen në ndihmë nevojtarit të këputur, kur i lutet Atij, që jua largon të keqen dhe ju bën ju trashëgimtarë në tokë? Vallë, a ka krahas Allahut zot tjetër? Sa pak që reflektoni!”**²²

Nëse njerëzit do të arrijnë ta njohin Allahun e Madhëruar, ashtu siç e meriton Ai njohjen, ata do ta besojnë, do ta adhurojnë dhe do t'i frikësohen Atij me vepra e me fjalë.

²² Sure “Neml”, ajetet 61-62.

2-NJOHJA E TË DËRGUARVE DHE E PROFETËVE (Pacja goftë mbi ta!)

Të njohësh të dërguarit dhe profetët e Allahut, do të thotë t'i marrësh shembull e model në jetën tënde. Në Kur'anin e Shenjtë ka shumë histori që flasin për profetët, për thirrjen e tyre në rrugën e Allahut, për përballjet e tyre me popujt kokëfortë e jobesimtarë dhe për triumfin e tyre. Allahu i Madhëruar thotë: **“Para teje, Ne kemi dërguar vetëm burra nga banorët e qyteteve, të cilët i frymëzuam me shpallje...”**²³

Dhe: **“Në tregimet e atyre (të Dërguarve) ka këshilla për ata që janë me mend...”**²⁴

Kur'ani i Shenjtë përdor metodën e historive për të përcjellë kuptime, njohuri dhe qëllime. Kjo metodë ka ndikim të madh në zemrat e njerëzve. Kjo vërteton atëherë se Kur'ani i Shenjtë është në përputhje të plotë me natyrën, mendjen dhe zemrën e njerëzve.

Allahu thotë në Kur'an: **“Çdo populli Ne i çuam një të Dërguar (që u thoshte): ‘Adhuroni Allahun dhe flakni idhujt!’ Disa prej tyre Allahu i çoi në Rrugë të Drejtë e disa**

²³ Sure “Jusuf”, ajeti 109.

²⁴ Sure “Jusuf”, ajeti 109.

e merituan të mbeten në humbje. Prandaj, udhëtoni nëpër botë të shihni se si ishte fundi i përgënjeshtresve!”²⁵

Historitë kur'anore përbëjnë një pjesë të rëndësishme të Kur'anit. Në disa hadithe thuhet se historitë janë një treta e Kur'anit dhe shumica prej tyre janë historitë e profetëve (*Paqja qoftë mbi ta!*). Disa sure të Kur'anit janë emërtuar me emrat e profetëve, si: *Ibrahim, Hud, Junus, Nuh*. Këto histori luajnë rol të madh në realizimin e qëllimeve të Kur'anit.

3-NJOHJA E RINGJALLJES DHE QARTËSIMI I ÇËSHTJEVE TË SAJ

Prej çështjeve të rëndësishme që përmban Kur'ani i Shenjtë është ajo e Ringjalljes. Kur'ani paraqet argumentet rreth vërtetësisë dhe mostjetërsimit të Jetës së Përtejme. Në të shumtën e rasteve, në Kur'anin e Shenjtë, besimi në Jetën Tjetër shoqërohet me besimin në Allahun e Madhëruar. Kur'ani thotë se besimtarë janë ata që besojnë në Allahun, në Ringjalljen dhe në Jetën Tjetër, kurse jobesimtarë janë ata që nuk besojnë as në Allahun, as në Ringjalljen e as në Jetën Tjetër.

²⁵ Sure “Nahl”, ajet 36.

Për të vërtetuar Ringjalljen dhe Jetën Tjetër, Kur'ani paraqet argumente të qarta logjike e të dukshme, që të zgjojë mohuesit dhe jobesimtarët prej gjumit të tyre të pavëmendshmërisë.

Në Kur'an thuhet: **“Ne lëshojmë nga qielli ujë të bekuar dhe nëpërmjet tij krijojmë kopshte, drithëra që korren dhe palma hurmash të larta me tufa frutash njëra mbi tjetrën si ushqim për robtë Tanë; në këtë mënyrë Ne me shi e ringjallim tokën e vdekur. E kështu do të jetë edhe Ringjallja.”**²⁶

Dhe: **“...Pastaj, kur t’ju thërrasë Ai, me një të thirrur, ju përnjëherë do të dilni nga toka (të ringjallur).”** (Sure “Rrum”, ajeti 25.) **“Atë Ditë, toka do të hapet e ata do të dalin me nxitim. Për Ne është e lehtë t’i mbledhim ata të gjithë.”** (Sure “Kaf”, ajeti 44.) **“Dhe, kur t’i fryhet Surit, ata do të dalin nga varret dhe do të nxitojnë drejt Zotit të tyre, duke thënë: ‘Mjerë ne! Kush na ngriti prej varreve tona?’”** (Do t’u thuhet): **‘Ja, kjo është ajo që ka premtuar i Gjithëmëshirshmi; të Dërguarit kanë thënë të vërtetën.’ Do të jetë ai vetëm një zë i tmerrshëm e ata të gjithë do të paraqiten para Nesh.”**²⁷ Për Ringjalljen Kur'ani paraqet edhe ndodhi historike, si ajo e Banorëve të Shpellës dhe e Uzejrit, të cilin Allahu e vdiq njëqind vjet pastaj e ringjalli

²⁶ Sure “Kaf”, ajetet 9-11.

²⁷ Sure “Jasin”, ajetet 51 – 53.

atë. Gjithashtu, Kur'ani kur flet për Jetën Tjetër, e paraqet atë si diçka të prekshme: Njeriu e përfytyron veten e tij në të dhe i shikon me sytë e tij bukuritë e Xhenetit apo tmerrin e Xhehenemit. Allahu thotë: **“Vërtet, besimtarët e devotshëm do të jenë në kopshtet e Xhenetit, ku rrjedhin lumenj, në kuvendin e së Vërtetës (në Xhenet), te një Sundues i Plotfuqishëm.”**²⁸

Dhe: **“Ngado që të hedhësh sytë, do të shohësh lumni dhe një mbretëri të madhe. Ata do të jenë të veshur me petka të holla mëndafshi të gjelbër dhe me armaç mëndafshi të trashë, të stolisur me byzylykë të argjendtë. Zoti i tyre do t’u japë të pinë pije të pastër. Ky do të jetë me të vërtetë shpërblimi juaj; përpjekjet tuaja do të jenë të pranuar...”**²⁹

Allahu i Madhëruar na urdhëron që t'i ruajmë vetat tona dhe familjet tona nga zjarri i Xhehenemit: **“O ju, që besoni! Ruani veten dhe familjet tuaja nga zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët! Atë e mbikëqyrin melekë të fuqishëm e të ashpër, të cilët kurrë nuk i kundërshtojnë urdhrat e Allahut, por i zbatojnë menjëherë ato.** (Sure “Tahrim”, ajeti 6)

²⁸ Sure “Kamer”, ajetet 54 - 55.

²⁹ Sure “Insan”, ajetet 20 -23.

4- UDHËZIMI NGA HUMBJA E DEVIJIMI

Kur'ani i Shenjtë është drita udhëzuese e Allahut dhe shpëtimtari nga humbja dhe devijimi. Allahu i Madhëruar thotë: **“Në të vërtetë, ky Kur'an udhëzon drejt asaj që është më e mira dhe u jep lajmin e gëzuar besimtarëve, që bëjnë vepra të mira se ata do të kenë shpërblim të madh.”**³⁰

Profeti Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi te dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: *“Unë kam lënë në mesin tuaj dy gjëra të rënda (me vlerë). Nëse kapeni fort pas tyre, ju kurrë nuk do të humbisni - Librin e Allahut dhe Ehli Bejtin tim. Ato të dyja kurrë nuk do të ndahen, derisa të vijnë te unë te Haudi (burimi i Keutherit).”*³¹

³⁰ Sure “Isra”, ajeti 9.

³¹ Ky hadith është transmetuar me këtë term dhe me terma të tjerë në mënyrë konsekuente (*muteuatir*) sipas kuptimit në: *Sahijhu Muslim*, 4: 1873/2408 dhe 5: 663/3786 dhe 3788. *El-Mustedrek* i Hakimit, 3: 148. *Musnedu Ahmed*, 3: 14, 17, 26, 59 dhe 4: 371, 5: 182 dhe 189. *Fadailu's-Sahabe* i Ahmed ibn Hanbelit, 2: 603/ 1035. *El-Khasais* i Nisaijut, 21. *Mesabijhu's-Sunneh*, 4: 185/4800 dhe 190/4816. *Mexhmau'z-Zeuaid*, 9: 163-164. *El-Xhamiu's-Sagijr* i Sujutijut, 1: 244/1608. *Es-Sauaiku'l-Muhrika* i Ibn Haxherit, 75 dhe 89. *El-Khasaisu'l-Kubra* i Sujutijut, 2: 266. *Tefsiri Ed-Durru'l-Menthur* i Sujutijut, 2: 60. *Tefsijru'r-Razij*, 8: 163. *Hiljetu'l-Eulija*, 1: 355. *Sunenu'l-Bejhakij*, 2: 148 dhe 7: 30. *Usdu'l-Gabeh*, 2: 13. *Tarijkhu Bagdad*, 8: 442. *El-Mu'xhemu'l-Kebijr* i Taberanijut, 3: 201/3052 e shumë të tjerë.

5- LARTËSIMI NË JETËN TJETËR

Çdo ajet prej *ajetëve* të Kur'anit të Shenjtë përfaqëson një shkallë prej shkallëve të Xhenetit. Sa herë që një njeri lexon a studion një ajet nga Libri i Allahut, Kur'ani i Shenjtë, aq herë ngjitet në shkallët e Xhenetit. Transmetohet se Profeti Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Numri i shkallëve të Xhenetit është sa numri i ajeteve të Kur'anit. Kur mbartësi i Kur'anit të hyjë në Xhenet, do t'i thuhet: *Lexo e ngjitu. Për çdo ajet ka një një shkallë. Mbi hafizin e Kur'anit nuk ka më shkallë.*”

6- SHËRIMI

Kur'ani i Shenjtë është shëruesi i vërtetë i sëmundjeve shpirtërore. Ai largon sëmundjet e zemrave. Ai është oksigjeni i lumturisë në të dyja jetët. Cilido që kërkon të pastrojë zemrën e tij prej sëmundjeve, papastërtive dhe gjynaheve, ai duhet të ndjekë dritën e Allahut, Fjalën e Tij, Kur'anin e Shenjtë. Allahu i Madhëruar thotë: **“Ne shpallim nga Kur'ani atë që është shërim dhe mëshirë për besimtarët e që mohuesve keqbërës u shton vetëm humbje.”**³²

³² Sure “*Isra*”, ajeti 82.

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Mësojeni Kur'anin sepse ai është pranvera e zemrave! Kërkoni shërim me dritën e tij sepse ai është shërues i kraharorëve!”³³

7- SHPËTIMI NGA DËNIMI

Allahu i Madhëruar nuk e dënon atë njeri që e mëson, e memorizon dhe e zbaton Kur'anin. Sepse një njeri i tillë është bërë Kur'an lëvizës në çdo hap që hedh në jetë dhe Kur'ani është bërë mbrojtësi i tij. Profeti Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Lexojeni Kur'anin dhe shfaqeni atë (në vepra e në fjalë) sepse Allahu nuk e dënon atë zemër që mbart Kur'anin.”³⁴

Të dashur vëllezër e të dashura motra!

Për t'u njohur sa më shumë me përmbajtjen e Kur'anit të Shenjtë, Fondacioni i Kur'anit ka përgatitur librin me titull: **“MËSIMET NGA SURET E SHKURTRA TË KUR'ANIT”**.

Burimet e përgatitjes së këtij libri janë:

1- Kur'ani i Shenjtë

³³ “Uesailu shiia”, vëllimi 6, faqe 167.

³⁴ “Uesailu shiia”, vëllimi 4, faqe 245.

2- Tefsijri "Nur", i eruditit dhe komentuesit Shejkh Muhsin Karaeti.

3- Komentimi i përsosur i Kur'anit, i eruditit dhe komentuesit Shejkh Nasir Mekarim Shirazij

4- Të njihemi me suret e Kur'anit, i autorit Xhafer Sheikh El Islami

Shpresojmë që me këtë libër t'i shërbejmë sado pak besimtarëve, duke i njohur ata me përmbajtjen e bekuar të Kur'anit të Shenjtë.

Allahu na e ndriçoftë jetën me dritën e Kur'anit!

Fondacioni i Kur'anit,

Haxhi Shejkh Vullnet Merja

MËSIMET NGA AJETET E SURES “ASR”

Në fillim të sures “Alak”, Allahu i Madhëruar thotë:

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

أَفْرَأَ بِاسْمِ رَبِّكَ الَّذِي خَلَقَ (1) خَلَقَ الْإِنْسَانَ مِنْ عَلَقٍ (2) أَفْرَأَ وَرَبُّكَ الْأَكْرَمُ (3) الَّذِي عَلَّمَ بِالْقَلَمِ (4) عَلَّمَ الْإِنْسَانَ مَا لَمْ يَعْلَمْ (5)

1. Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi (gjithçka),
2. e krijoi njeriun nga një droçkë gjaku!
3. Lexo! Zoti yt është Bujari më i madh,
4. i Cili, me anë të penës ia mësoi,
5. ia mësoi njeriut ato që nuk i dinte.³⁵

Kur’ani i Shenjtë është Fjala e Allahut dhe mrekullia e përjetshme, të cilën Allahu ia shpalli vulës së profetëve,

³⁵ Këto janë ajetet e para që iu shpallën Profetit Muhamed (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!).

Profetit Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Ai është burimi themelor i besimit dhe i ligjshmërisë së fesë së pastër islame. Asgjë nuk është më lart se Kur'ani. Cilido që e kupton, ashtu siç duhet Kur'anin dhe e zbaton në jetën e tij, sigurisht që do të jetojë një jetë të kënaqshme e të lumtur. Kur'ani është libri i jetës dhe këtë e dëshmon vetë Kur'ani i Shenjtë, i cili thotë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا اسْتَجِيبُوا لِلَّهِ وَلِلرَّسُولِ إِذَا دَعَاكُمْ لِمَا يُحْيِيكُمْ...

“O ju që keni besuar! Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit kur ju thërret drejt asaj që ju jep jetë...”³⁶ Pa dyshim, ndjekja e Kur'anit dhe zbatimi i tij e rigjallëron njeriun dhe e drejton drejt rrugës së Krijuesit.

Sot do të paraqesim disa nga mësimet e sures “Asr”.

بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِیْمِ

وَالْعَصْرِ (1) إِنَّ الْإِنْسَانَ لَفِي خُسْرٍ (2) إِلَّا الَّذِينَ ءَامَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ وَتَوَاصَوْا بِالْحَقِّ وَتَوَاصَوْا بِالصَّبْرِ (3)

Me Emrin e All'lahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. Beto hem në kohën!

³⁶ Sure “Enfal”, ajeti 24.

2. Me të vërtetë, njeriu është në humbje,

3. përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, i këshillojnë njëri-tjetrit të Vërtetën e i këshillojnë njëri-tjetrit durimin.

Mirësia e leximit të sures “Asr”

Imam Xhafer Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë:
“Atë, që e lexon (a e këndon) suren Uel Asr gjatë namazeve nafîle, Ditën e Kiametit Zoti, do ta ringjallë me fytyrë plot dritë e të qeshur dhe me sy që shkëlqejnë (prej të mirave të Zotit), derisa të hyjë në Xhenet.”³⁷

NGA KJO SURE MËSOJMË:

1- Këto ajete përmbajnë katër shtylla për lumturinë: e para: besimi; e dyta: vepra e mirë; e treta: ftesa për tek e vërteta; e katërta: durimi.

2- Allahu betohet në kohën dhe kjo do të thotë se koha ka vlerë të madhe dhe njeriu duhet ta shfrytëzojë për të mira.

³⁷ “Mexhmaul Bejan”, vëll 10, f 545

3- Njeriu është gjithmonë humbës.

4- Rruga e vetme për t'u mbrojtur nga humbja është besimi dhe puna e mirë, siç thuhet në ajetin 3 të kësaj sureje: **“përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira...”**

5- Besimtari nuk duhet të mjaftohet vetëm për veten e tij por duhet të mendojë edhe për udhëzimin e të tjerëve: **“i këshillojnë njëri-tjetrit të vërtetën”**

6- Duhet të këshillojmë për durim sepse durimi është çelësi i mirësive. Por durimi nuk duhet të kuptohet si nënshtrim. Durimi duhet të shoqërohet me përpjekje e lëvizje.

7- Besimi është pararojë e veprës së mirë. Edukimi i vetes qëndron para edukimit të shoqërisë. Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *“Kushdo që e vendos veten e tij imam (prijës), ai duhet të fillojë me edukimin e vetes së tij përpara se të fillojë edukimin e të tjerëve.”*

8- Këshillimi i të tjerëve për të Vërtetën dhe për durimin nuk mund të arrihet pa këshilluar për besimin dhe veprën e mirë. Nëse mungon besimi dhe vepra e mirë, humbja do të jetë shumë e madhe.

9- E Vërteta dhe e drejta kanë nevojë për qëndrueshmëri dhe palëkundshmëri.

10- Kur të gjithë njerëzit zbatojnë të urdhëruarit në të mirë dhe ndalojnë nga e keqja, atëherë e gjithë shoqëria do të jetë e drejtë dhe do të jetojë në paqe, siguri, harmoni, begati dhe lumturi.

11- Shpëtimi nga humbja arrihet kur njerëzit bëjnë vetëm punë të mira.

12- Besimi duhet të jetë i plotë dhe jo i pjesshëm; pra, duhen besuar të gjitha parimet dhe dispozitat e fesë.

13- Dikush përpigjet të shtojë pasurinë dhe të ndërtojë kështjella, ndërkohë që ka humbur pasurinë e shpirtit. Një tjetër e humbet pasurinë e shpirtit për të arritur pozitë. Disa të tjerë e humbasin atë, për t'u dëfryer. Përfundimi: Asnjëri prej tyre nuk mund të jetë pronar i asaj pasurie të madhe shpirtërore, sepse ajo është vlerë që arrihet vetëm duke qenë i kënaqur me Allahun dhe All'illahu të jetë i kënaqur me njeriun.

14- Çdo rrahje që bën zemra, e afron njeriun drejt fundit të jetës në këtë botë. Prandaj, duhet të bëjmë vepra që na shpëtojmë nga humbja.

MËSIMET NGA AJETET E SURES “HUMEZE”

“Humeze” është surja e 104 e Kur'anit të Shenjtë dhe ka 9 ajete. Është në xhuzin e 30-të të Kur'anit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

وَبُلْ لِكُلِّ هَمَزَةٍ لُّمَزَةٍ الَّذِي (1) جَمَعَ مَالًا وَعَدَّدَهُ (2) يَحْسَبُ أَنَّ مَالَهُ أَخْلَدَهُ (3) كَلَّا لَيُنْبَذَنَّ فِي
الْحُطَمَةِ (4) وَمَا أَدْرَاكَ مَا الْحُطَمَةُ (5) نَارُ اللَّهِ الْمَوْقُودَةُ (6) الَّتِي تَطَّلِعُ عَلَى الْأَفْئِدَةِ (7) إِنَّهَا
عَلَيْهِمْ مُؤَصَّدَةٌ (8) فِي عَمَدٍ مُّمَدَّدَةٍ (9)

**Me Emrin e All'Ilahut, të Gjithëmëshirshmit,
Mëshirëplotit**

1. Mjerë për çdo përqeshës - shpifës,
2. i cili grumbullon pasuri dhe e ruan,
3. duke menduar se ajo pasuri do ta bëjë të pavdekshëm!
4. Jo, aspak! Në të vërtetë, ai do të hidhet në torturën shkatërruese.

5. E kush mund të ta shpjegojë ty se çfarë është tortura shkatërruese?

6. Ajo është zjarri i Allahut i ndezur fort,

7. i cili depërton deri në zemrën e njeriut.

8. Ai do t'i rrethojë ata nga çdo anë,

9. në shtylla të gjata flakëruese.

Sipas komentuesve, kuptimi i fjalës humeze dhe lumeze është thyerje e personalitetit, fyerje, shpifje, kërkim i të metave (tek të tjerët).

Përmbajtja e sures: Qortim për ata njerëz që vetëm grumbullojnë pasuri dhe pasurinë e konsiderojnë më të rëndësishmen dhe që i tallin e i përqeshin të tjerët. Qortim për pasanikët të egër, egoistë e hileqarë, të cilët kënaqen dhe argëtohen duke tallur, përbuzur dhe përqeshur të tjerët.

Në hadithe të ardhura nga Profeti dhe familja e tij e pastër flitet për mirësitë e leximit të sureve të Kur'anit. Për mirësitë e leximit të sures "Humeze" imam Xhafer Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *"Atij, që e lexon (a e këndon) suren "Humeze" në namazet farz, i largohet varfëria, i shtohet rrisku dhe pasuria dhe nuk do të ketë vdekje të shëmtuar."*

NGA KJO SURE MËSOJMË:

1- Feja islame e konsideron shumë të rëndësishëm personalitetin dhe nderin e njeriut. Ndaj përgojimin dhe fyerjen e njeriut e konsideron gjynah shumë të madh. Në një hadith të Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) thuhet: “Njerëzit më të ulët janë ata që shpifin për të tjerët.”.

2- Tallja dhe përqeshja e të tjerëve çon në mjerim, siç thotë ajeti i parë i kësaj surje: **“Mjerë për ata që përqeshin dhe tallin!”** Pra, mjerë për ata që me gjuhën e tyre thumbojnë dhe me lëvizjen e duarve, të syve dhe të vetullave përqeshin e fyejnë pas shpine të tjerët apo shpifin e tallin! Mjerë ata që kanë qëllim talljen dhe shpifjen në fjalë e në veprime!

3- Tallja dhe përqeshja e të tjerëve janë prej gjynaheve të mëdha dhe gjynahet e mëdha të çojnë në dënimin më të rëndë.

4- Ka shumë të pasur që i poshtërojnë, i përcmojnë e i fyejnë të tjerët. Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “A dëshironi t’ju flas për njerëzit më ngatërrestarë?” - Po, - o i Dërguari i All'llahut! - iu përgjigjën. Ai u tha: “Janë ata që merren me thashetheme në mes miqsh, krijojnë ndasi dhe kërkojnë të gjejnë mangësi të njerëzit e pastër dhe të pamëkatë.”

5- Çështjet e moralit janë pjesë e fesë. Dhe besimari duhet të sundojë shikimin e tij dhe gjuhën e tij.

6- Duhet të ruhemi nga mashtrimi i kësaj bote dhe të mos ndryshojmë për shkak të pasurisë. Të mos shkelim kufijtë e caktuar nga Allahu, siç thuhet në suren “Alak”, ajetet 6-7: **“Por, vërtet që njeriu shkel çdo cak, kur mendon se është i vetëmjaftueshëm.”**

7- Disa njerëz kënaqen kur numërojnë paratë e tyre dhe krekosen me to, duke menduar se kjo pasuri do jetë përherë me ta dhe se ajo do t'i bëjë të përjetshëm në këtë botë dhe nuk do t'i prekë as sëmundja dhe as vdekja. Sa mendim i gabuar dhe sa imagjinatë e zbrazët! Edhe Karuni pati aq shumë mall e pasuri, saqë edhe çelësat e thesareve ishin në dorën e tij. Por ato nuk i shërbyen për asgjë. Ato nuk mundën ta vononin vdekjen e tij. Allahu i Madhëruar e zhduku pasurinë e tij me një tërmet: **“Ne bëmë që Karunin dhe shtëpinë e tij t'i gëlltiste toka dhe askush nuk arriti që ta mbronte nga dënimi i Allahut; madje, as ai vetë nuk mund ta mbronte veten.”**

8- Asgjë nuk është e përjetshme në këtë botë sado që të hamendësojë njeriu se është i pavdekshëm. Në suren “Rahman” ajetet 26-27 thuhet: **“Çdo gjë që është në Tokë, do të zhduket, e do të mbetet vetëm Fytyra (Qenia) e Zotit Tënd, plot Madhëri dhe Nderim.”**

Në një hadith të Profetit Muhamed thuhet: *“Bëhu në këtë botë si një i huaj, si të jesh kalimtar dhe llogarite veten në mesin e të vdekurve!”*³⁸

9- Ata që grumbullojnë pasuri dhe nuk e shpenzojnë për hir të Allahut, le të presin dënimin e rëndë të Allahut!

10- Dënimi në Jetën Tjetër është i pashmangshëm për ata që bëjnë gjynahe e të këqija.

11- Allahu nuk dënon vetëm trupat. Dënimi i Tij depërton deri në thellësi të shpritrave e të zemrave të gjynahqarëve, siç thotë ajeti: **“i cili depërton deri në zemrën e njeriut.”**

12- Në fundin e kësaj sureje thuhet se tallësit dhe përqeshësit do të jenë në Xhehenem me dyer të bllokuara. Shtyllat e zjarrit ua bllokojnë rrugën banorëve të zjarrit dhe nuk mund të ikin prej Zjarrit, siç thotë ajeti i 9 i kësaj sureje të begatë: **“në shtylla të gjata flakëruese.”**

³⁸ “Amalij” i Tusit, 819/381.

MËSIMET NGA AJETET E SURES FIJL

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

أَلَمْ تَرَ كَيْفَ فَعَلَ رَبُّكَ بِأَصْحَابِ الْفِيلِ ﴿١﴾ أَلَمْ يَجْعَلْ كَيْدَهُمْ فِي تَضْلِيلٍ ﴿٢﴾ وَأَرْسَلَ عَلَيْهِمْ
طَيْرًا أَبَابِيلَ ﴿٣﴾ تَزْمِيهِمْ بِحِجَارَةٍ مِنْ سِجِّيلٍ ﴿٤﴾ فَجَعَلَهُمْ كَعَصْفٍ مَأْكُولٍ ﴿٥﴾

Me Emrin e All'Ilahut, të Gjithëmëshirshmit,
Mëshirëplotit

1. Vallë, a nuk ke dëgjuar ti se si bëri Zoti yt me njerëzit e elefantit?
2. A nuk ua prishi atyre kurthin,
3. duke dërguar kundër atyre tufa zogjsh,
4. të cilët i gjuajtën me gurë prej baltës së pjekur?
5. Dhe kështu, i bëri si byk i coptuar.

Kjo Sure është Surja 105 në xhuzin e 30 të Kur'anit.

Mirësitë e leximit të sures “El Fijl”

Për mirësitë e leximit të kësaj sureje, imam Sadiku (Paqja e Zotit qoftë mbi të!) ka thënë: *“Kushdo që e lexon këtë sure (“Fijl”), në namazet farz, Ditën e Gjykimit, gjithçka që është në Tokë, do të dëshmojë se ky njeri është prej namazfalësve. Gjithashtu, do të thërrasin për të se ai është prej njerëzve që thotë të vërtetën dhe do të futet në Xhenet, pa dhënë llogari. Xheneti do të thotë se e do këtë njeri dhe veprat e tij.”* Sigurisht, mirësia e leximit të sures fitohet, nëse veprohet ashtu siç urdhëron në të Allahu.

NGA KJO SURE MËSOJMË:

1- Historia që përmban Surja u tregon dhe u rikujton jobesimtarëve mendjemëdhenj se janë të pafuqishëm përballë fuqisë së Allahut. Allahu i Madhëruar i godet mendjemëdhenjtë dhe arrogantët kokëfortë me mënyra të ndryshme, duke ua treguar atyre vendin, siç veproi me Nemrudin, Faraonin, popullin e Nuhut, popullin e Lutit etj.

2- Abraha së bashku me ushtrinë e tij erdhën nga Jemeni për të shkatërruar shtëpinë e Zotit; por Allahu, me një ushtri, që në pamje të jashtme dukej e vogël dhe e papërfillshme, i rrëzoi ata përtokë. Allahu bëri që elefantët e mëdhenj, të rrëzoheshin përtokë nga zogjtë e vegjël. Dhe

gjitha kjo ishte të tregonte fuqinë absolute të Krijuesit ndaj njeriut mendjemadh, Abrahass. Eh sa shumë Abrahass ka sot!

3- Kjo ngjarje tregon se nuk është e thënë që mrekullitë dhe veprat e jashtëzakonshme, të bëhen vetëm me dorën e Profetit dhe të të dashurve të Allahut. Por Allahu e bën mrekullinë si të dojë dhe me kë të dojë. Kurdo që Allahu e shikon të nevojshme, bën mrekulli që njerëzit të njohin të Vërtetën.

4- Në këtë ngjarje është treguar se Qabja do të jetë gjithmonë e sigurt dhe se ajo ka një Zot që e mbron.

5- Të mësojmë e të përfitojmë nga shembujt dhe historitë që përmend Kur'ani sepse ato përmbajnë mësimë madhështore.

6- Kurrë të mos e harrojmë historinë sepse ajo luan rol të madh në jetën tonë. Duke mësuar historinë e pastër nga sajessat, një popull mëson të kaluarën, shpjegon të tashmen dhe parashikon të ardhmen. Kur e mëson historinë e pastër nga sajessat, e di se kush janë armiqtë e vërtetë të tij, cilat janë gabimet që janë bërë në të kaluarën dhe cilat kanë qenë rrethanat që kanë çuar në ato ngjarje historike.

7- Qabja ka qenë e Shenjtë edhe para Islamit. Fyerja dhe përbaltja e Shenjtërive meritojnë dënim të rëndë.

8- Ndëshkimi i mëkatarëve dhe keqbërësve nga Allahu është shfaqje e fuqisë dhe e sundimit absolut të Allahut Fuqiplotë.

9- Zogjtë e zbatuan detyrën e ngarkuar nga Allahu. Po ne përse kundërshtojmë?!

10- Duhet të dihen kurthet e armikut dhe të prishen ato, siç thotë ajeti: **“A nuk ua prishi atyre kurthin.”**

11- Edhe nëse armiku ka mjete të mëdha për të shkatërruar, siç bëri Abraha, i cili kishte elefantë të mëdhenj për të shembur Qaben, Allahu ia shkatërroi me zogj të vegjël.

MËSIMI NGA AJETET E SURES “KUREJSH”

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

لِيَأْتِيَهُمْ قُرَيْشٌ (1) إِعْلَانٌ لِّفِيهِمْ رِحْلَةَ الْشِّتَاءِ وَالصَّيْفِ (2) فَلْيَعْبُدُوا رَبَّ هَذَا الْبَيْتِ (3) الَّذِي
أَطْعَمَهُمْ مِّنْ جُوعٍ وَعَاءَمَّهُمْ مِّنْ حَوْفٍ

Me Emrin e All'Ilahut, të Gjithëmëshirshmit,
Mëshirëplotit

“Për hir të garantimit që e gëzojnë kurejshitet,”

“Për t’i mbrojtur ata në udhëtimin që bëjnë dimër e verë.”

“Prandaj le të adhurojnë Zotin e kësaj shtëpie (Qabes),”

“I Cili i ushqen ata në ditë urie dhe i siguron në ditë frike.”

Surja “Kurejsh” është e 106-ta e Kur'anit. Është në xhuzin e 30-të. Ka 4 ajete. Kjo Sure i kushtohet fisit kurejsh dhe të mirave që Zoti u fali pjesëtarëve të këtij fisi.

Mirësitë e leximit të kësaj sureje

Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: *“Kushdo që e lexon këtë sure, merr dhjetë mirësi, sa janë të gjithë ata që bëjnë tauafin e Qabes.”*

Sigurisht, që mirësia është për ata që e adhurojnë Allahun me sinqeritet, dhe e respektojnë Shtëpinë e Allahut.

Edhe pse i kushtohet fisi Kurejsh, mësimet që përmban kjo Sure janë për çdo kohë dhe për çdo vend.

NGA KJO SURE MËSOJMË:

1- Mposhtja e armikut është faktor i unitetit. Dhe uniteti është domosdoshmëri për myslimanët. Kur'ani fton për bashkim dhe unitet, siç thotë ajeti 103 i sures “Ali Imran”: **“Të gjithë mbahuni fort për litarin e Allahut (Kur'anin) dhe mos u përçani! Kujtoni dhënëtinë e Allahut për ju, sepse, kur ishit në armiqësi, Ai i pajtoi zemrat tuaja e, në saje të dhënëtisë së Tij, u bëtë vëllezër. Dhe ju ishit buzë greminës së zjarrit, ndërsa Ai ju shpëtoi prej saj. Kështu, Allahu jua shpjegon Shpalljet e Veta, që ju të drejtoheni në Udhën e Drejtë.”**

2- Uniteti dhe marrëdhëniet e mira në mesin e shoqërisë është mirësi e Allahut. Dhe kjo mirësi duhet të

ruhet nga njerëzit. Profeti Muhamed sillej mirë me njerëzit dhe ftonte për unitet. Në ajetin 159 të sures “Ali Imran” thuhet: **“Në saje të mëshirës së Allahut, u solle butësisht me ta (o Muhamed). Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje...”**

3- Të gjithë njerëzit duhet ta adhurojnë Allahun. Këtë e konfirmon ajeti 21 i sures “Bekare” i cili thotë:

﴿يَا أَيُّهَا النَّاسُ اعْبُدُوا رَبَّكُمُ الَّذِي خَلَقَكُمْ وَالَّذِينَ مِنْ قَبْلِكُمْ لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ﴾

“O njerëz! Adhuroni Zotin Tuaj, i Cili ju ka krijuar ju dhe ata që ishin para jush, që të mund të ruheni (nga të këqijat).”

Në suren Dharijat, ajeti 56 thuhet:

﴿وَمَا خَلَقْتُ الْجِنَّ وَالْإِنْسَ إِلَّا لِيَعْبُدُونِ﴾

“Xhindet dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë.”

4- Një ndër qëllimet e adhurimit është të falënderohet Mirësuesi, Allahu i Madhëruar.

5- Rëndësia e adhurimit qëndron në faktin se ai është rruga drejt arritjes tek Allahu i Plotfuqishëm. Adhurimi

është qëllimi i krijimit të njeriut, i bërjes së tij mëkëmbës në Tokë dhe i pastrimit të njeriut nga papastërtitë dhe devijimet, në mënyrë që ai të jetë më afër me Allahun dhe të arrijë kënaqësinë e Tij.

6- Të gjitha adhurimet në Islam synojnë që njerëzit të pastrojnë shpirtin dhe trupin e të forcojnë vullnetin.

7- Adhurimet janë si miraxhi. Përmes tyre shpirti njerëzor lartësohet shkallë pas shkalle, derisa të arrijë kthjelltësinë e pastërtinë dhe arrin ta kuptojë më mirë Botën e Përtejme dhe e zbulon të Vërtetën e ekzistencës. Adhurimet e lartësojnë njeriun në këtë jetë dhe e lidhin më shumë me Jetën Tjetër, që është jeta e vërtetë.

8- Adhurimi i Allahut duhet të jetë i vazhdueshëm dhe jo i përkohshëm a me raste të veçanta, si, për shembull, vetëm në ditën e xhuma, në bajrame a në Natën e Kadrit. Adhurimet duhet të kryhen deri në fund të jetës. Ajeti 99 i sures “Hixhr” thotë:

وَأَعْبُدْ رَبَّكَ حَتَّىٰ بِأَتَيْتَكَ الْيَقِينَ،

“Dhe adhuroje Zotin tënd derisa të të vijë vdekja!”

Adhurimet duhet të bëhen me sinqeritet dhe përkushtim, siç thotë ajeti 5 i sures “Bejjine”:

وَمَا أُمِرُوا إِلَّا لِيَعْبُدُوا اللَّهَ مُخْلِصِينَ لَهُ الدِّينَ حُنَفَاءَ وَيُقِيمُوا الصَّلَاةَ وَيُؤْتُوا الزَّكَاةَ وَذَلِكَ دِينُ الْقَيِّمَةِ

“E, ata ishin urdhëruar vetëm që të adhuronin Allahun me përkushtim të sinqertë, duke qenë në fenë e pastër (të Ibrahimit), si dhe të falnin namazin e të jepnin zekatin. Kjo është feja e drejtë.”

9- Të gjitha adhurimet kanë ndikim reformues te individi, te trupi dhe shpirti i tij. Po ashtu, kanë ndikim reformues në sistemin shoqëror.

10- Adhurimi nuk ka për qëllim të braktiset jetesa e kësaj jete. Këtë e dëshmon ajeti 77 i Sures “Kasas”:

وَابْتَغِ فِيمَا آتَاكَ اللَّهُ الدَّارَ الْآخِرَةَ وَلَا تَنْسَ نَصِيبَكَ مِنَ الدُّنْيَا وَأَحْسِنَ كَمَا أَحْسَنَ اللَّهُ إِلَيْكَ وَلَا تَبْغِ الْفُسَادَ فِي الْأَرْضِ إِنَّ اللَّهَ لَا يُحِبُّ الْمُفْسِدِينَ

“Por përpiqu me atë që të ka dhënë Allahu të fitosh jetën e Botës së Ardhshme, duke mos harruar pjesën tënde në këtë botë! Bëju mirë të tjerëve, ashtu siç të ka bërë mirë ty Allahu! Mos kërko shkatërrim në Tokë, sepse Allahu nuk i do shkatërrimtarët!”

11- Është Allahu Ai që e rregullon çështjen e Qabes sepse Ai është pronari i saj.

12- Karakteristikë e njeriut është ndjenja e urisë dhe nevoja e tij për ushqim. Sigurimi i kësaj nevoje tregon mirësinë dhe mëshirën e Allahut për njerëzit.

13- Allahu është Mbrojtësi. Në ajetin 256 të Sures “Bekare” Allahu thotë: **“Allahu është Mbrojtësi i atyre që besojnë. Ai i nxjerr ata nga errësira në dritë.”**

Islami e lejon udhëtimin për të siguruar jetesën. Në ajetin 56 të sures “Ankebut” thuhet:

يَا عِبَادِيَ الَّذِينَ آمَنُوا إِنَّ أَرْضِي وَاسِعَةٌ فَإِيَّايَ فَاعْبُدُونِ

“O ju robtë e Mi, që keni besuar! Toka Ime është, vërtet e gjerë. Prandaj më adhuroni vetëm Mua!”

14- Në suren “Kurejsh” shpjegohet shumë mirë që njëri prej qëllimeve të sures “El Fijl” është rikujtesa për mirësitë e mëdha, që Allahu u ka dhënë kurejshëve. Kjo rikujtesë vlen edhe për ne dhe për çdo kohë.

Të dashur vëllezër, të dashura motra!

Nëse i bindemi Allahut dhe të Dërguarit të Tij, e adhurojmë Allahun dhe zbatojmë urdhrat Tij dhe dhe porosinë e Profetit, pa dyshim që Allahu do të jetë i kënaqur me ne në këtë jetë dhe në Jetën Tjetër do të jemi me punëmirët, dëshmorët e të sinqertët, siç thotë ajeti 69 i sures “Nisa”:

وَمَنْ يُطِيعِ اللَّهَ وَالرَّسُولَ فَأُولَئِكَ مَعَ الَّذِينَ أَنْعَمَ اللَّهُ عَلَيْهِمْ مِنَ النَّبِيِّينَ وَالصَّادِقِينَ
وَالشُّهَدَاءِ وَالصَّالِحِينَ وَحَسُنَ أُولَئِكَ رَفِيقًا

“Kushdo që i bindet Allahut dhe të Dërguarit, do të jetë me ata të cilëve Allahu u ka dhënë shumë mirësi: me profetët, me të sinqertët, me dëshmorët dhe me të drejtët. Eh sa shokë të mrekullueshëm janë këta!”

MËSIMET NGA AJETET E SURES “EL MÂ’ÛN”

Në suren “En'am”, ajeti 155 Allahu i Madhëruar thotë:

﴿وَهَذَا كِتَابٌ أَنْزَلْنَاهُ مُبَارَكٌ فَاتَّبِعُوهُ وَاتَّقُوا لَعَلَّكُمْ تُرْحَمُونَ﴾

“Ky Libër që kemi shpallur, është i bekuar. Prandaj ndiqeni dhe druajuni kundërshtimit, në mënyrë që të mëshiroheni.”

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: *“Lexojeni Kur'anin dhe mësojeni përmendsh atë, sepse Allahu i Madhëruar nuk do ta ndëshkojë atë zemër, që e ka kuptuar Kur'anin.”*³⁹

Surja “El Mâ’ûn” është surja e 107-të e Kur'anit. Është në xhuzin e 30-të. Ka 7 ajete.

Në këtë sure Allahu i Madhëruar thotë:

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

³⁹ “Mustedrekul Uesail”, vëll. 4, f. 245.

أَرَأَيْتَ الَّذِي يَكْتَدِبُ بِالَّذِينَ فَذَلِكَ الَّذِي يَدْعُ الْيَتِيمَ وَلَا يَحْضُرُ عَلَى طَعَامِ الْمُسْكِينِ قَوْلًا
لِّلْمُضِلِّينَ الَّذِينَ هُمْ عَنْ صَلَاتِهِمْ سَاهُونَ الَّذِينَ هُمْ يُرَاؤُونَ وَيَمْنَعُونَ الْمَاعُونَ

Me Emrin e All'lahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. A e ke parë atë që mohon Ditën e Llogarisë?
2. Ky është ai që i dëbon ashpër jetimët
3. dhe nuk nxit që t'i jepet ushqim të varfrit.
4. Mjerë për ata, të cilët kur falen,
5. janë të pakujdesshëm për namazet,
6. që duan vetëm të duken
7. dhe nuk u japin ndihmë nevojtarëve.

Mirësitë e leximit të sures "El Mâ'ûn"

Sa u përket mirësive të kësaj surje në një hadith të imam Bakirit (*Paqja qoftë mbi të!*) lexojmë: "Kushdo që e lexon këtë sure në namazet e detyrueshme (farz) dhe ato të pëlqyera, Zoti i Madhëruar do t'ia pranojë namazin dhe agjërimin e tij. Allahu nuk do t'ia llogarisë gabimet që ka bërë gjatë jetës në këtë botë."

NGA SURJA "EL MÂ'ÛN" MËSOJMË:

1- Largimi i jetimit e largon njeriun nga Allahu. Dhe, ai njeri që është larg Allahut, është larg mirësisë dhe afër shejtanit.

2- Kujdesi për jetimin, nevojtarët e të uriturit është prej shenjave të besimit. Në Kur'an jetimi përmendet 23 herë.

3- Lidhja e fortë mes besimit dhe punës.

4- Nevoja shpirtërore është më e parë se nevoja trupore. Prandaj në ajet, fillimisht përmendet dashuria për jetimin e më pas ushqimi i të varfërve.

5- Jo çdo namaz është i pranueshëm dhe jo çdo namazfalës hyn në Xhenet.

6- Pakujdesia meriton qortimin. Por, sigurisht që qortimi duhet të jetë në formën më të mirë e larg ashpërsisë.

7- Është e pafalshme lënia e namazit. Sepse namazi është shtylla e fesë: Nëse pranohet namazi, pranohen të gjitha veprat e tjera të mira. Në suren "Muddeththir", ajetet 42-43 lexojmë se pyetja e parë që do t'u bëhet atyre që do hyjnë në Xhehenem është: **"Çfarë ju ka sjellë në Sekar? Ata do të përgjigjen: 'Nuk ishim nga ata që falnin namaz.'" Kush e braktis namazin, nuk gjen falje.**

8- Rreziku më i madh është kur vepra e keqe e njeriut bëhet pjesë e jetes së tij, pra, kur ai mohon, gënjen, mashtron, përgënjeshtron, nuk ndihmon, etj, siç thotë kjo Sure.

9- Sinqeriteti është kusht për pranimin e adhurimeve.

10- Ndhimja për të varfërit, e çdo lloji qoftë, nuk është e posaçme vetëm për të pasurit. Ajo është detyrë e të gjithëve, sipas mundësive që kanë.

11- Ajeti na thotë se mjerimi përfshin personin, që është i shkujdesur ndaj namazit. Por, çfarë mund të thuhet për atë person që e braktis faljen e namazit?

12- Shërbimi ndaj njerëzve është vepër madhore dhe e shpërblyer; ndërsa shpërfillja për nevojat e domosdoshme të njerëzve ka dënim.

13- Ai njeri që largohet nga Allahu, përpiqet të fitojë pozitë para njerëzve me dyfytirësi, shtirje dhe mburrje. Në një prej haditheve të Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i All'lahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) thuhet: “Do të vijë një kohë te njerëzit, kur zemra e tyre do të jetë e keqe dhe e ndyrë, ndërsa pamja e jashtme e tyre do të jetë shumë e bukur, sepse ata nuk kanë asnjë dëshirë për shpërblimin e Allahut, feja e tyre është sa për sy e faqe, ata nuk i frikësohen Zotit. Zoti do t'i dënojë ata

shumë keq. Sa herë që ta konsiderojnë Zotin si të huaj, asnjëherë lutjet e tyre nuk do të pranohen.”⁴⁰

Dhe: “Personi që kryen punë sa për sy e faqe e për t’u dukur, Ditën e Kiametit do të thirret me katër emra: qafir, i ndyrë, hilecak, punëlig. Medet për ty! Veprat e tua u zhdukën dhe shpërblimi vajti dëm. Sot asnjë gjë nuk të shpëton. Kërkoje dhe merre shpërblimin tënd nga ajo që ke bërë!”⁴¹

Në një hadith të imam Sadikut (Paqja e Zotit qoftë mbi të!) thuhet se i ka thënë shokut të tij, Zurara: “Ai që bën vepra për njerëzit, edhe sevapi për to është, o Zurara! Çdo punë e bërë për sy e faqe, për t’u dukur, është shirk.”⁴²

14- Koprracia është vepër e shëmtuar. Zoti i Madhëruar i konsideron pa iman dhe pa të përgjegjshëm njerëzit koprracë dhe egoistë dhe i fut tek ata që s’e kanë mirë as me Zotin e as me njeriun. Të tillë njerëz nuk mendojnë as për shpërblimin hyjnor e as për dënimin hyjnor. Koprracia nuk mund të bashkohet me besimin. Në një hadith thuhet se: *Kopraci është larg Allahut dhe larg njerëzve.* Në suren “Ali Imran”, ajeti 180, Allahu i Madhëruar thotë për koprracët: **“Ata që bëhen koprracë me të mirat që ua ka dhënë Allahu, kurrsesi të mos mendojnë se kështu është më mirë për ata! Jo, kjo është më keq për**

⁴⁰ “Usulul Kafi”, vëll. 2, Hadithi 14.

⁴¹ “Usulul Kafi”, vëll. 2, kreu “Err rrijau, Dukja”, Hadithi 14.

⁴² “Uesailul Shiah”, vëll. 1, f. 49, në vazhdim të hadithit 11.

ata! Ajo që kanë grumbulluar do t'u ngarkohet atyre në qafë Ditën e Gjykimit. E Allahut është trashëgimia e qiejve dhe e Tokës dhe Allahu e di mirë ç'punoni ju."

Të dashur vëllezër, të dashura motra!

Kjo Sure e begatë na mëson që të mos mohojmë, të mos gënjejmë, të mos i dëbojmë jetimët, të mos jemi të shkujdesur, të mos jemi kopracë, të mos jemi prej atyre që i përfshin mjerimi. Allahu na thotë:

{وَقَالِ أَعْمَلُوا فَسِيرِيَ اللَّهِ عَمَلَكُمْ وَرَسُولُهُ وَالْمُؤْمِنُونَ ۖ وَسَتُرَدُّونَ إِلَىٰ عِلْمِ الْغَيْبِ وَالشَّهَادَةِ فَيُنَبِّئُكُمْ بِمَا كُنْتُمْ تَعْمَلُونَ}

"Thuaj: Punoni se Allahu, i Dërguari i Tij dhe besimtarët do të shohin punën tuaj. Së shpejti do të ktheheni tek Ai që di të dukshmen dhe të padukshmen e Ai do t'ju njoftojë për atë që keni bërë."⁴³

Qofshim prej punëmirëve në këtë jetë dhe prej atyre me fytyra të bardha në Jetën Tjetër!

⁴³ Sure "Teube", ajeti 105.

MËSIMET NGA AJETET E SURES “KEUTHER”

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

إِنَّا أَعْطَيْنَاكَ الْكُوفَةَ فَصَلِّ لِرَبِّكَ وَأَنْحَرْ إِنَّ شَائِئَكَ هُوَ الْأَبْتَرُ

**Me Emrin e All'Ilahut, të Gjithëmëshirshmit,
Mëshirëplotit**

- 1. Me të vërtetë, Ne të kemi dhënë ty shumë të mira.**
- 2. Prandaj, falu për Zotin tënd dhe bëj kurban!**
- 3. Sigurisht, ai që të urren ty, është vetë farësosur.**

Kjo është surja e 108-të e Kur'anit. Është surja më e shkurtër. E ka marrë emrin “Keuther”, për arsye të ajetit të parë. Fjala “Keuther” ka kuptimin e mirësisë së madhe dhe të bereqetit të pafundmë. Sipas disa transmetimeve, fjala “Keuther” ka edhe kuptimin “një prej lumenjve të Xhennetit”. Thuhet se Surja ka zbritur për vajzën e Profetit Muhamed, Fatime Zahranë (*Paqja qoftë mbi të!*) kur Profetit i vdiqën djemtë dhe politeistët mekas filluan të thonë se Profeti është farësosur dhe do të harrohet emri i tij sepse nuk

ka pasardhës. Kështu që Allahu i zbriti Profetit suren “Keuther” si përgjigje për fjalët e politeistëve.

Mirësitë e Allahut për Profetin Muhamed nganjëherë ishin nga kërkesa e tij siç për shembull: *O Zoti im! Ma shto diturinë!* Mirëpo *Keutheri* është dhuratë nga Allahu për të dashurin e Tij, Profetin Muhamed. Ky *Keuther* i bekuar i Profetit, pra, Fatimja, është fryt i martesës e tij me hazreti Hatixhenë, e cila shpenzoi pasurinë e saj për përhapjen e Islamit dhe Allahu i dha *Keutherin*, Fatimenë.

Keutheri, pra, e dhëna e Allahut, nuk është e kufizuar me llojin, sepse Ai është i Gjithëditur për njerëzit. Fatimja ishte vajzë, por ajo u bë *keuther*. Fatimja ishte një person i vetëm dhe u bë *keuther* = mirësi e madhe. Allahu është i Plotfuqishëm dhe të paktën e bën *keuther* e të vazhdueshëm dhe të shumtën e fshin dhe e zhduk.

Atëherë kur lindja e vajzës ishte hidhërim për babain, atëherë kur i nxihej fytyra se kishte lindur vajzë dhe mendonte se si të largohej nga njerëzit apo ta varroste të gjallë, (Shih ajetin 59 i sures “Nahl”: **“Ai fshihet nga njerëzit për shkak të lajmit të keq që mori dhe s’di a ta mbajë këtë fëmijë, pavarësisht poshtërimit apo ta varrosë në dhé. Ah! Sa mbrapsht që gjykojnë ata!”**), pikërisht në këtë kohë Kur'ani e shndërron vajzën në *Keuther*, duke e zëvendësuar kulturën xhahilite, të injorancës, me kulturën

humane. **“Me të vërtetë që Ne të kemi dhënë ty mirësi të madhe.”**

Fakhru Razij, në tefsirin e tij thotë: “E ku gjenden pasardhës më të bereqetshëm se pasardhësit e Fatimes, prej të cilëve ishin Bakiri, Sadiku, Rizai. Edhe pse një numër i madh i tyre u martirizuan në kohën e sunduesve emevitë dhe abasitë, sot kanë shumë pasardhës në shumë vende të botës.

Ndër 114 suret e Kur'anit, janë katër sure që fillojnë me frazën: *Inna- Ne. Surja “Fet'h”, Surja “Nuh”, Surja “Kadr” dhe Surja “Keuther”.*

Në një nga këto katër suret përmendet profeti Nuh (*Paqja qoftë mbi të!*) që është prej profetëve të vendosmërisë së lartë. Kurse tek tri suret e tjera përmendet një mirësi e veçantë si: *Zbritja e Kur'anit, Triumfi i madh dhe Dhënia e madhe - Keutheri*. Ka mundësi që mes këtyre katër përmendjeve të ketë një lidhje: njëra prej tyre sqaron mesazhin e një prej të dërguarve të mëdhenj e të vendosmërisë së lartë; tjetra flet për zbritjen e Librit të fundit qiellor; e treta flet për triumfin e fesë islame; e katërta flet për vazhdimësinë e Mesazhit islam nëpërmjet pasardhësve të hazreti Fatimesë (*Paqja qoftë mbi të!*).

Mirësitë e leximit të këesaj Sureje

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: *“Kushdo që e këndon dhe e lexon këtë Sure, do t'i shuhet etja nga lumenjtë e Xhenetit, do të shpërblehet me masën e çdo kurbanit që bëhet në ditën e Bajramit të Kurbanit dhe me masën e kurbaneve që bëjnë Ehli Kitabi dhe Mushrikët.”*⁴⁴

NGA KJO SURE MËSOJMË:

1- Allahu e përmbush premtimin e Tij dhe kurrë nuk e thyen premtimin. Në suren “Duha”, Allahu i premtoi Profetit Muhamed se do t'i jepte: **“E, sigurisht që Zoti yt do të të japë ty, sa të jesh i kënaqur.”** Dhe në këtë Sure Allahu thotë: **“Me të vërtetë që Ne të kemi dhënë ty mirësi të madhe.”** Atëhere, gjithmonë të jemi të bindur se Allahu do të na e japë atë që dëshirojmë edhe nëse mund të vonohet e kurrë të mos e humbim shpresën tek Allahu.

2- Prej dhënëtive të Allahut janë fëmija dhe pasardhësit me qëllim që shoqëria njerëzore të vazhdojë.

3- Jo çdo mbushulli (bollëk) është Keuther, sepse në ajetin 55 të sures “Teube” Allahu thotë: **“Mos u josh (o**

⁴⁴ Tefsiri “*Mexhmaul Bejan*”, vëll. 10, f. 548.

Muhamed) nga pasuria dhe fëmijët e tyre, sepse nëpërmjet tyre Allahu kërkon t'i ndëshkojë ata në këtë jetë, kështu që t'u dalë shpirti duke qenë jobesimtarë." Në Kur'an janë surja "Keuther" dhe surja "Tekathur". *Keutheri* është diçka e çmueshme kurse *tekathur* është e kundërta e së çmueshmes. *Keuther* është dhënia e Allahut dhe e pason përmendja e Allahut: "Me të vërtetë, Ne të kemi dhënë ty shumë të mira. Prandaj, falu për Zotin tënd." *Tekathur* është mburrje negative dhe e pason pakujdesia ndaj përmendjes së Allahut: "Ju ka hutuar rivaliteti për të shtuar."

4- Dhënia duhet të pasohet me përgjegjësinë që kemi para Allahut. Allahu na mirëson, dhe ne duhet ta falënderojmë Allahun e ta adhurojmë Atë. Edhe nëse nuk na mirëson, duhet ta falënderojmë (Të dhamë... falu...). Pra, përderisa dhënia është nga Allahu, duhet që edhe falënderimi të jetë për Allahun.

5- Falënderimi të jetë i menjëhershëm për Krijuesin dhe për krijesën.

6- Nuk duhet ta harrojmë Allahun kur jemi në mirëqënie e të gëzuar. As kur nuk jemi në mirëqënie e nuk jemi të gëzuar. "Me të vërtetë që Ne të kemi dhënë ty mirësi të madhe. Prandaj falu..."

7- Falënderimi për Allahun kryhet duke falur namazin sepse namazi është mënyra më e plotë e adhurimit. Në namaz njeriu duhet të jetë tërësisht i pranishëm, me trup e me zemër. Fatime Zahraja, bija e Profetit Muhamed ka thënë: *“Allahu e ka bërë për ju namazin pastrim nga mendjemadhësia.”*

8- Urdhrat e fesë janë në përputhje të plotë me logjikën dhe natyrën e pastër të njeriut. Logjika dhe natyra e pastër e njeriut na urdhërojnë për domosdoshmërinë e falënderimit. Po ashtu edhe feja.

9- Bërja e kurbanit për Allahun është një formë tjetër falënderimi. Therja e kurbanit është solidarizim me nevojtarët dhe të varfrit.

10- Ai që do shumë mirësi, nuk duhet të mjaftohet me therjen e një dashi, por të therë më shumë. Ajeti i dytë i kësaj Sureje përmend fjalën *nahr*, që ka kuptimin “therje e devesë” dhe nuk thotë *idhbah* që përdoret për “therjen e bagëtive të tjera”. Kjo tregon se kur Allahu të ka dhënë shumë mirësi, edhe ti duhet të japësh shumë për hir të Allahut.

11- Marrëdhënia me Allahun është më parësore se marrëdhënia me njerëzit. Në këtë Sure fillimish thuhet “**Falu**”, që ka lidhje me Allahun; pastaj thuhet “**bëj kurban**”, që ka lidhje me njerëzit.

12- Dhënia ka vlerë kur shoqërohet me besimin dhe me adhurimin: **“Prandaj, falu për Zotin tënd dhe ther kurban!”**

13- Falënderimi i Allahut bëhet kur u jep njerëzve.

14- Kurrë nuk do të triumfojnë armiqtë e Profetit e të fesë së tij. Asnjëherë nuk duhet t'u frikësohemi talljeve dhe fyerjeve sepse Allahu është Mbrojtësi i të dashurve të Tij.

15- Nuk lejohet fyerja e Shenjtërive. Të qëndrojmë sa më larg talljes e fyerjes. Po ashtu, të qëndrojmë larg gjykimit të nxituar. Të mos e gjykojmë njëri-tjetrin bazuar nga pamja e jashtme, siç ndodh që gjykohet libri nga kopertina e tij.

16- Nuk duhet të nxitohemi në gjykimin e të tjerëve dhe as të mbështetemi vetëm te përllogaritjet dhe statistikat sepse çdo gjë është e lidhur me dëshirën e Allahut Fuqplotë. Gjykimi i kundërshtarëve të Profetit, të cilët kishin djem, pas vdekjes së djemëve të tij se ishte farësosur, u përmbys kur zbriti kjo Sure e cila në fillim thotë: **“Me të vërtetë që Ne të kemi dhënë ty mirësi të madhe”** (mirësia ishte vajza e tij, Fatimja) dhe në fund thotë: **“Sigurisht, ai që të urren ty, ai vetë është farësosur.”** Allahu është i Plotfuqishëm për çdo gjë. Ai është i Plotfuqishëm të krijojë një mirësi të madhe, si Fatime Zahraja, po ashtu të fshijë përmendjen e një personi që ka shumë djem. Ai është i Plotfuqishëm që me shkopin e Musait të hapë detin e të nxjerrë ujë nga guri.

MËSIMET NGA AJETET E SURES “KAFIRUN”

Në ajetin 8 të sures “Tegabun” Allahu thotë:

فَأْمِنُوا بِاللَّهِ وَرَسُولِهِ وَالنُّورِ الَّذِي أَنْزَلْنَا وَاللَّهُ بِمَا تَعْمَلُونَ خَبِيرٌ

“Prandaj besoni në Allahun, në të Dërguarin e Tij dhe në dritën (Kur'anin), që ju kemi zbritur. Allahu e di mirë çdo gjë që bëni ju.”

Kur'ani është një thesar i madh. Ai përmban atë që i nevojitet individit, familjes dhe shoqërisë për të përparuar dhe për të arritur lartësimin. Ai trajton moralin individual, të cilin ligjet shoqërore ose e trajtojnë pjesërisht sipas dëshirave dhe tekave të ligjvënësve, ose nuk e trajtojnë fare.

Kur'ani Famëlartë është busulla e besimtarëve. Ai i furnizon ata me atë që duan. Kur'ani i bashkon dhe i udhëzon në rrugën e shpëtimit në Ditën e Gjykimit. Kush i përmbahet Librit të Allahut në të gjitha aspektet, është i shpëtuar.

Sot do të paraqesim disa nga mësimet e sures “Kafirun”. Kjo është surja e 109-të e Kur'anit dhe ka 6 ajete.

Në këtë sure Allahu i Madhëruar thotë:

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

قُلْ يَا أَيُّهَا الْكَافِرُونَ لَا أَعْبُدُ مَا تَعْبُدُونَ وَلَا أَنْتُمْ عَابِدُونَ مَا أَعْبُدُ وَلَا أَنَا عَابِدٌ مَّا عَبَدْتُمْ وَلَا أَنْتُمْ عَابِدُونَ مَا أَعْبُدُ لَكُمْ دِينُكُمْ وَلِيَ دِينِ

**Me Emrin e All'Ilahut, të Gjithëmëshirshmit,
Mëshirëplotit**

- 1. Thuaj: O ju jobesimtarë!**
- 2. Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuroni**
- 3. dhe ju nuk adhuroni Atë që unë adhuroj.**
- 4. Unë nuk do të jem kurrë adhurues i atyre që ju i adhuroni**
- 5. dhe as ju nuk do të jeni adhurues të Atij që unë adhuroj.**
- 6. Ju keni fenë tuaj; unë kam fenë time.**

Mirësitë e leximit të sures “El Kâfirûn”

Janë transmetuar shumë hadithe për mirësitë e leximit të kësaj sureje, të cilat tregojnë rëndësinë e jashtëzakonshme të saj. Në një hadith të Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i All’llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) thuhet: “Ai që e lexon suren ‘El Kâfirûn’, është sikur ka lexuar çerekun e Kur’anit. Shejtani largohet prej tij, pastrohet prej shirkut dhe do të jetë i sigurt Ditën e Gjykimit.”

Vlerësimi me një çerek të Kur’anit, është ndoshta për arsye se një e katërta e Kur’anit flet për luftën kundër shirkut dhe idhujve.

NGA KJO SURE MËSOJMË:

1- Profeti Muhamed ishte besnik i Shpalljes: Ai përcillte vetëm ato që i shpallte Allahu. Profeti e ka për detyrë ta ruajë me kujdes atë çka i shpall All’llahu në Kur’an dhe ta përcjelljë për të tjerët në të njëjtën mënyrë. Kjo gjë tregon që Xhibraili dhe Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk kanë ndryshuar as thënien më të vogël. Kjo tregon, gjithashtu, se që të dy janë të besueshëm dhe urdhrin e Allahut e dëgjojnë dhe e zbatojnë përpikërisht.

2- Myslimanët duhet t'u përgjigjen thënieve jologjike prerazi, që kundërshtari të ndiejë paaftësi, ashtu siç u tha Profeti prerazi jobesimtarëve: **“Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuroni.”**

3- Nuk duhet të heqim dorë nga parimet dhe vlerat islame duke u arsyetuar me unitetitn. Është detyrë mirësjellja dhe respekti, por jo lënia e parimeve dhe e vlerave islame.

4- Në çdo kohë që dëgjon fjalë të pavlera, besimtari largohet nga aty.

5- Nuk duhet bërë tregti me fenë. As nuk duhet nënshtruar para propozimeve të vazhdueshme jologjike. Duhet të jemi të palëkundur në parimet e vlerat e Islamit.

6- Nuk duhet bërë asnjë punë që ka për qëllim tëreqjen e vëmendjes së të tjerëve.

7- Qëndrueshmëria dhe vendosmëria janë virtytete të larta që e ndihmojnë njeriun në jetën e tij. Këto janë kusht edhe për udhëheqjen e drejtë.

8- Adhurimi i Allahut është etaloni dallues mes besimtarit dhe jobesimtarit.

9- Njeriu është i lirë të zgjedhë fenë e tij. Në fe nuk ka detyrim dhe nuk është i imponuar: **“Ju keni fenë tuaj, ndërsa unë kam fenë time. Nuk ka dhunë në fe.”**

10- Është detyrë që të bëhet dallimi mes së Vërtetës dhe të pavërtetës, besimit dhe mohimit, të drejtës dhe të padrejtës.

11- Është detyrë që myslimanët të mësojnë që në asnjë rast të mos njëmendësohen me armikun në punë të fesë dhe të Islamit. Sa herë që armiku ta kërkojë këtë gjë, ta lënë pa shpresë. Jo më kot në këtë Sure është cituar dy herë: **“Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuroni”**. Është thënë për t’i zhgënjyer e për t’i lënë të pashpresë ata që nuk besojnë në Islam. Është cituar dy herë edhe: **“As ju nuk do të jeni adhurues të Atij që unë adhuroj”**, për të treguar kokëfortësinë e tyre. Përfundimi: **“Ju keni fenë tuaj; unë kam fenë time!”**. Unë dhe feja ime (Teuhidi), ju dhe feja juaj e prishur (idhujtaria).

12- Teuhidi nuk shkon me shirkun. Janë dy drejtime të kundërta dhe nuk kanë asnjë ngjashmëri me njëri-tjetrin. Teuhidi e lidh njeriun me Allahun; shirku e ndan njeriun nga Allahu. Teuhidi është sekreti i unitetit në të gjitha fushat; shirku është ndarje dhe grindje në të gjitha rastet. Teuhidi e ngre njeriun lart në botën materiale dhe në botën shpirtërore; shirku e hedh njeriun në pusin e errët të materiales dhe e bashkon atë me krijesat e ulëta dhe të

dobëta. Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), si dhe të gjithë Profetët e tjerë nuk e pranuan kurrë idhujtarinë; përkundrazi, e para gjë dhe më e rëndësishmja që ata bënë, qe lufta kundër idhujtarisë.

Edhe sot, të gjithë duhet ta ndjekim Rrugën e Drejtë dhe ta vazhdojmë atë në çdo vend e në çdo kohë. Kudo e kurdo të tregojmë që jemi kundër shirkut dhe nuk bëjmë kompromis me të. Kjo është Rruga e Drejtë e fesë islame.

Të dashur vëllezër, të dashura motra:

Kur'ani i Shenjtë, jo vetëm inkurajon për të bërë vepra të mira, por me mësimet e tij, e nxit myslimanin t'u përmbahet mësimëve të Islamit. Sa më e madhe dhe më e fuqishme të jetë afërsia e myslimanit me Kur'anin, aq më e sinqertë, më e vazhdueshme dhe më e përsosur do të jetë puna e tij. Atëherë, të mos jem prej atyre, për të cilët Kur'ani thotë:

« وَلَا تَكُونُوا كَالَّذِينَ نَسُوا اللَّهَ فَأَنْسَاهُمْ أَنْفُسَهُمْ أُولَٰئِكَ هُمُ الْفَٰسِقُونَ »

“Mos u bëni si ata që e harruan Allahun, kështu që Ai i bëri të harronin vetveten! Pikërisht ata janë të pabindurit (ndaj Allahut).” Gjithmonë ta kujtojmë Allahun dhe të jemi në Rrugën e Allahut sepse nuk janë të barabartë banorët e Xhehenemit me ata të Xhenetit, siç thotë ajeti 20 i sures Hashr:

لَا يَسْتَوِي أَصْحَابُ النَّارِ وَأَصْحَابُ الْجَنَّةِ ۗ أَصْحَابُ الْجَنَّةِ هُمُ الْفَائِزُونَ

“Nuk janë të barabartë banorët e Xhehenemit dhe banorët e Xhenetit; banorët e Xhenetit do të jenë të fituarit.”

Qofshim prej banorëve të Xhenetit!

MËSIMET NGA AJETET E SURES “NASR”

Në ajetin 82 të sures “Isra” Allahu i Madhëruar thotë:

وَنَزَّلُ مِنَ الْقُرْآنِ مَا هُوَ شِفَاءٌ وَرَحْمَةٌ لِّلْمُؤْمِنِينَ ۗ وَلَا يَزِيدُ الظَّالِمِينَ إِلَّا خَسَارًا

“Ne shpallim nga Kur'ani atë që është shërim dhe mëshirë për besimtarët e që të padrejtëve u shton vetëm humbje.”

Libri i Allahut, Kur'ani i Shenjtë është i pandryshueshëm dhe i tillë do të jetë deri në fund të kësaj jete. Në ajetin 41 dhe 42 të sures “Fussilet” thuhet:

وَإِنَّهُ لَكِتَابٌ عَزِيزٌ ۚ لَا يَأْتِيهِ الضَّلْمُ ۚ وَمِن بَيْن يَدَيْهِ وَمِن خَلْفِهِ ۗ تَنزِيلٌ مِّن حَكِيمٍ حَمِيدٍ

“Ai është vërtet një Libër i madhërueshëm. Atij nuk mund t'i afrohet gënjeshtër nga asnjëra anë. Ai është Shpallje prej një të Urti, që meriton të gjitha lavdet.”

Islami dhe Kur'ani kanë ardhur për të ndërtuar njeriun e vërtetë. Qëllimi i zbritjes së këtij Libri të Shenjtë

është që prej tij të përfitojnë të gjithë njerëzit sipas mundësive të tyre.

Sot do të flasim për mësimet nga surja “Nasr”.

Kjo është surja e 110-të e Kur’anit. Ka 3 ajete

Në këtë Sure Allahu i Madhëruar thotë:

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

إِذَا جَاءَ نَصْرُ اللَّهِ وَالْفَتْحُ وَرَأَيْتَ النَّاسَ يَدْخُلُونَ فِي دِينِ اللَّهِ أَفْوَاجًا فَسَبِّحْ بِحَمْدِ رَبِّكَ وَاسْتَغْفِرْهُ
إِنَّهُ كَانَ تَوَّابًا

Me Emrin e All’Ilahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. Kur të vijë ndihma e Allahut dhe çlirimi (i Mekës).
2. Dhe t’i shohësh njerëzit duke hyrë në fenë e Allahut grupe-grupe.
3. Atëherë madhëroje me falënderim Zotin tënd dhe kërko falje nga Ai sepse Ai është, vërtet Pranues i madh i pendimeve.

Mirësia e leximit të kësaj sureje

Në një hadith të Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i All'lahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) për mirësitë e leximit të kësaj sureje, thuhet: *“Ai që e lexon suren ‘Nasr’, është sikur ka qenë së bashku me Profetin Muhamed (Paqja e bekimi i All'lahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) në çlirimin e Mekës.”*

Gjithë kjo krenari dhe mirësi është për atë që e lexon Suren dhe ecën në Rrugën e Profetit të Allahut dhe e vë në zbatim çdo synet të tij e nuk mjaftohet vetëm me të thënë e tyre.

NGA KJO SURE MËSOJMË:

1- Fitorja arrihet me ndihmën e Allahut. Nuk duhet mburrur e krekosur, sepse çdo gjë vjen nga Allahu i Plotfuqishëm. Në ajetin 126 të sures “Ali Imran” Allahu thotë: **“...Vërtet, fitorja është vetëm nga Allahu, i Plotfuqishmi dhe i Urti.”** Ka raste që mundësitë njerëzore dhe ushtarake janë të pranishme; mirëpo nuk arrihet fitorja. Në ajetin 249 të sures “Bekare” thuhet: **“Sa herë, me ndihmën e Allahut, një ushtri e vogël ka triumfuar mbi një ushtri të madhe...”**

2- Dita e çlirimit të Mekës shpresa e idhujtarëve u shndërrua në zemërim. Qendra e idhujtarisë u shndërrua në qendër Teuhijdi. Në atë ditë madhështore të gjitha pengesat u shkatërruan para besimtarëve dhe Islami u përhap dhe u forcua më shumë. Dita e çlirimit të Mekës ishte dita e mëshirës dhe jo dita e masakrës. Në atë ditë madhështore Profeti u tha atyre që e patën sharë, ofenduar, lënduar dhe dëbuar: *Shkoni ju jeni të lirë. A ka mëshirë më të madhe?!*

3- Sipas mundësisë së tyre, myslimanët e kanë detyrë që të përpiqen dhe të krijojnë shkaqe e arsye që njerëzit të hyjnë në Islam. Nuk duhet të krijojnë mure ndarëse, por të krijojnë kopshte me lule shumëngjyrshë me aromën e besimit, të paqes, respektit, dashurisë, mirëkuptimit, harmonisë. Të veprojnë siç veprouan Profeti Muhamed, familja e tij e pastër dhe shokët e tij të zgjedhur.

4- Kur largohen pengesat para fesë, njerëzit hyjnë turma-turma në të. Pengesa më e madhe sot është islamofobia dhe padituria për Islamin. Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *Njeriu është armik i asaj që nuk e njeh.*

5- Para çlirimit të Mekës njerëzit hynin një nga një në Islam. Por pas çlirimit të Mekës ata hynë turma-turma në të. Kjo tregon madhësinë e fesë së pastër islame, e cila është në përputhje të plotë me natyrën e njeriut dhe me nevojat e tij.

6- Allahu është i pamëkatë. Lartësimi i Tij duhet të shoqërohet me falënderim e lëvdata për mirësitë e Tij.

7- Lëvdata, falënderimi dhe lartësimi i Allahut janë parakusht për kërkimin e faljes. Kërkimi i faljes nganjëherë është për ndriçimin më shumë të zemrës, nganjëherë për faljen e gjynaheve të ymmeti.

8- Kur vepërmirët e të devotëshmit vijnë në drejtim/në udhëheqje, e aromatizojnë shpirtin e tyre me përmendjen e Allahut në vend të mendjemadhësisë.

9- Ndihma e Allahut është e kushtëzuar me ndihmën e njerëzve për fenë e Tij. Në ajetin 7 të sures "Muhamed" thuhet: **"O ju që keni besuar! Nëse e ndihmoni Allahun (fenë e Tij), edhe Ai do t'ju ndihmojë dhe do t'ju bëjë të qëndroni fort në këmbët tuaja."**

10- Çdo njeri, deri edhe Profeti, duhet të kërkojë falje pasi e falënderon dhe e lartëson Allahun. Profeti ka thënë: *"Kërkojini falje Allahut sepse unë i kërkoj falje Atij shtatëdhjetë herë në ditë."*

11- Allahu e pranon pendimin. *Fjala teuuab përmendet 11 herë në Kur'an. Në nëntë vende kjo fjalë shoqërohet me fjalën rahmetun = mëshirë. (Teuuaben Rrahijmen).* Një herë shoqërohet me urtësinë dhe një herë përmendet në formë përgjithësuese. Dhe kjo përmendet në këtë sure (Nasr). Në ajetin 8 të sures "Tahrijm" thuhet: **"O ju, që keni besuar!**

Kthehuni tek Allahu me një pendim të sinqertë, që Zoti juaj t’jua shlyejë gabimet e t’ju çojë në kopshte, nëpër të cilët rrjedhin lumenj, Ditën, kur Allahu nuk do t’i turpërojë Profetin dhe ata që besuan bashkë me atë. Drita e tyre do të shkëlqejë para tyre dhe në të djathtë të tyre. Ata do të thonë: ‘O Zoti ynë, përsose dritën tonë dhe falna ne! Vërtet, Ti je i Fuqishëm për gjithçka.’”

MËSIMET NGA AJETET E SURES “MESED

Profeti Muhammed (*Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Kush ka mall për Allahun, le t'i dëgjojë fjalët e Tij!”.⁴⁵

Shumë herë na bën djalli që të harrojmë Zotin tonë, fenë tonë, kushtetutën tonë-Kur'anin, përgjegjësitë tona, qëllimin e krijimit tonë. Ajetet e Kur'anit na kujtojnë ato që ne harojmë, siç thotë ajeti 54 i sures “Gafir”:

هُدًى وَذِكْرٍ لِّلْأُولَى الْأَلْبَابِ

“Si udhërrëfyes dhe përmendës për ata që mendojnë.”

Do të përmendim mësimet që na vijnë nga surja “Mesed”.

“Mesed” është surja e 111-të e Kur'anit. Ka 5 ajete.

⁴⁵ “Kenzul Ummal”, hadithi 2472

Allahu i Madhëruar në këtë sure thotë:

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

تَبَّتْ يَدَا أَبِي لَهَبٍ وَتَبَّ مَا أَغْنَىٰ عَنْهُ مَالُهُ وَمَا كَسَبَ سَيَصْلَىٰ نَارًا ذَاتَ لَهَبٍ وَامْرَأَتُهُ حَمَّالَةَ
الْحَطَبِ فِي جِيدِهَا حَبْلٌ مِّن مَّسَدٍ

Me Emrin e All'Ilahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. Iu thafshin duart Ebu Lehebit dhe u thaftë në gjithçka!
2. Nuk do ta ndihmojnë atë as pasuria dhe as fitimet e tjera.
3. Ai, me siguri, do të hidhet në zjarrin me flakë të tërbuara.
4. Po ashtu edhe gruaja e tij, mbartësja e druve.
5. Në qafën e saj do të ketë një litar prej fijesh palme.

Mirësia e leximit të sures “Mesed”

Në hadithin e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i All'Ilahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) thuhet: “Atë që e lexon këtë

sure, shpresoj që Zoti të mos e bashkojë në një vend me Ebu Lehebin.”

NGA KJO SURE MËSOJMË:

1- Kundërshtimi i atyre që bëjnë shkatërrime në Tokë është pjesë e fesë dhe nuk lejohet përkrahja e tyre.

2- Vendimit të Allahut për shkatërrimin e Ebu Lehebit dhe prishja e komplotit që ai po kurdiste kundër të Dërguarit të Allahut, Profetit Muhamed, (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk është vetëm për atë kohë. Ajo është dhe do të jetë deri në fund të kësaj jete sepse në çdo kohë ka Ebu Lehebë, ashtu siç ka edhe faraonë e fundi i tyre do të jetë shkatërrimi.

3- Ata që fyejnë Shenjtëritë e vërteta, do të kenë mallkim të përjetshëm.

4- Duhet të luftohet kufri (mosbesimi) dhe të bëhet lutje për zhdukjen e tij, sepse mosbesimi sjell shkatërrim për njerëzimin. Profeti Nuh (*Paqja qoftë mbi të!*) iu drejtua Allahut me këto fjalë: **“O Zoti im, mos lër mbi Tokë asnjë femohues! Nëse Ti i lë, ata do t’i çojnë në humbje robtë e Tu dhe do të lindin vetëm keqbërës dhe jobesimtarë.”**⁴⁶

⁴⁶ Sure “Nuh”, ajetet 26-27

5- Një prej mjeteve të kundërshtarëve të profetëve ishte pasuria dhe paraja. Mirëpo, jo vetëm Ebu Lehebit, po asnjë jobesimtari dhe punëligu nuk do t'i bëjë dobi as pasuria e as pushteti. Ata nuk do mund t'i shpëtojnë dënimit të Allahut. As pasuria, as paraja e as pushteti nuk mund t'i mbrojnë nga dënimi i Allahut, sikurse thuhet edhe në ajetet 88-89 të sures "Esh Shuara": **"Ditën, kur askujt nuk do t'i bëjnë dobi as pasuria, as fëmijët, përveç atij që vjen me zemër të pastër tek Allahu."**

6- Më e keqe se e keqja është përsëritja e veprimit të keq, siç vepronte bashkëshortja e Ebu Lehebit., **Hammaletul Hatab**. Mbarte dru. Disa komentues thonë se ajo mbarte idhuj dhe i hidhte para Profetit Muhamed.

7- Dënimi nga Allahu nuk është larg. Keqbërësit do të marrin ndëshkimin që meritojnë.

8- Mendjemadhësia në këtë botë do të jetë poshtërim në Botën Tjetër.

9- Është absolutisht e ndaluar lëndimi i besimtarëve. Në ajetin 58 të sures "Ahzab" thuhet:

وَالَّذِينَ يُؤْذُونَ الْمُؤْمِنِينَ وَالْمُؤْمِنَاتِ بَغَيْرِ مَا كَانُوا فَتَدِ احْتَمَلُوا هَيْتَانَا وَانَّمَا مِثْلُنَا

"Ata që i lëndojnë besimtarët dhe besimtare, duke i akuzuar për diçka që nuk e kanë bërë, në të vërtetë, i

kanë ngarkuar vetes fajin për shpifje dhe një gjynah të qartë.”

10- Ditën e Gjykimit nuk bën dobi lidhja farefisnore dhe as nuk të largon asgjë nga dënimi. Ebu Lehebi ishte xhaxhai i Profetit, por ai do të jetë prej banorëve të Xhehenemit.

11- Humbja më e madhe për njeriun në këtë jetë është kur ai merret me luftimin e fesë së Allahut me fjalë e vepra e veprime të kota e të pavlera. Mirëpo, duke vepruar kështu, ai i shpall luftë Zotit të Madhëruar e të Lartësuar. Dhe në këtë ai është humbës, sepse e sheh fenë e Zotit të Plotfuqishëm të përhapet dhe ai bëhet edhe më i pafuqishëm përballë përhapjes së saj. Pse? Sepse e Vërteta është gjithmonë më e fuqishme se e pavërteta. Sa e sa njerëz a regjime janë përballur me fenë. Ato u zhdukën. Feja jo. Feja qëndron. Feja është e Zotit dhe Zoti është Ai që garanton mbështetjen, mbrojtjen dhe qëndrueshmërinë e saj. Ajo që u thuhet islamofobëve është thënia e Allahut në Kur'an: *Mutuu fi gajdhikum* “**Vdisni në atë mllefin tuaj!**”

12- Një mësim tjetër është se qenia më e nderuar tek Allahu i Madhëruar nuk varet nga prejardhja, por nga devotshmëria, nga përkushtimi, siç thuhet në Kur'an: “**inne ekrmekum indAll’lilahi etkakum**” “**më i miri ndër ju tek Allahu është më i devotshmi prej jush.**”

Islami nuk e favorizon askënd për shkak të prestigjit, autoritetit, familjes a fisit të tij, por e trajton atë sipas punës dhe veprave të tij. Profeti Muhamed i ka thënë vajzës së tij: “Oj Fatime, bija e Muhamedit, puno, se unë nuk të bëj dobi para Zotit!”

Ebu Lehebi, ishte xhaxhai i të Dërguarit të Allahut, nga familja e profetësisë dhe një nga prijësit e Kurejshëve, i autoritetshëm (Zoti e turpëroftë dhe e mallkoftë!), mirëpo farefisnia e tij me Profetin (*Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk i solli dobi.

13 - Një mësim tjetër është madhështia e së drejtës së Profetit (*Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Dëshmia për këtë është se Zoti i Madhëruar ishte Mbrojtësi i Profetit nga kurthet dhe intrigat e jobesimtarëve, prej të cilëve ishte edhe xhaxhai i tij, Ebu Lehebi.

MËSIMET NGA AJETET E SURES "IKHLAS"

Në suren "En'am", ajeti 155, Allahu i Madhëruar thotë:

وَهَذَا كِتَابٌ أَنْزَلْنَاهُ مُبَارَكٌ فَاتَّبِعُوهُ وَاتَّقُوا لَعَلَّكُمْ تُرْحَمُونَ

"Ky Libër që kemi shpallur, është i bekuar, prandaj ndiqeni dhe frikësojuni kundërshtimit, në mënyrë që të mëshiroheni."

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimet e Alahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i ka thënë Selman Farisiut: "O Selman, lexoje Kur'anin, sepse leximi i tij është shlyerje e mëkateve, mbulesë në Xhehenem dhe siguri nga mundimi!"⁴⁷

Kur'ani i Shenjtë është themeli i fesë dhe porta e Islamit. Është Libri i Krijuesit, ku Ai ka vendosur ligjet e Tij dhe të vërtetat e fesë së Tij dhe ua ka zbritur njerëzve si udhërrëfyes dhe pishtar për t'i nxjerrë ata nga errësirat në dritë. Allahu urdhëron që t'i përmbahemi fort Kur'anit, sepse ai është Fjala dhe Vullneti i Tij i plotë për njerëzimin

⁴⁷ "Kenzul Ummal", i Mutekij El Hindij, vëll. 1, f. 510.

për çdo kohë dhe për vend. Kushdo që dëshiron të arrijë tek Allahu, le të ndjekë rrugën e Tij dhe të udhëzohet me udhëzimin e Tij. Kush është i udhëzuar, i afrohet Allahut, kush humbet, i largohet Allahut.

Këtu do të paraqesim mësimet që përmban surja “Ikhlas”, ose, siç njihet ndryshe surja “Kulhu uAll’lillahu ehad”. Kjo është surja e 112-të e Kur’anit. Ka katër (4) ajete.

Në këtë Sure Allahu i Madhëruar thotë:

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ اللَّهُ الصَّمَدُ لَمْ يَلِدْ وَلَمْ يُولَدْ وَلَمْ يَكُنْ لَهُ كُفُوًا أَحَدٌ

Me Emrin e All’lillahu, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

- 1. Thuaj: Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm.**
- 2. Allahu është Absoluti, të Cilit i përgjërohet gjithçka në amshim.**
- 3. Ai as nuk lind, as nuk është i lindur.**
- 4. Dhe askush nuk është i barabartë (a i krahasueshëm) me Atë.**

Kjo sure e begatë flet për Njëshmërinë e Allahut. Në katër ajete të shkurtra është përshkruar në mënyrën më të

përsosur Njëshmëria e Allahut. Në një hadith të imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) përmendet arsyeja e zbritjes së sures "Ikhlas". Në hadith thuhet se një jahudi i kërkoi të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) t'i përshkruante Allahun. Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) qëndroi tri ditë në heshtje dhe nuk i ktheu përgjigje, derisa zbriti kjo sure."

Mirësitë e leximit të sures "Ikhlas"

Janë përcjellë shumë hadithe për mirësitë e leximit të kësaj Sureje. Një prej haditheve të Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) thotë: "Kush prej jush është i pamundur që të lexojë një të tretën e Kur'anit në një natë?!". - O i Dërguari i Allahut! Po kush mund të bëjë një punë të tillë, në një natë?! - tha një prej të pranishmëve. - Lexoni suren "Kulhu'uAll'lahu e had", - tha Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

NGA KJO SURE MËSOJMË:

1- Profetët janë besnikë të Shpalljes. Këtë e vërteton edhe thënia ("Kul"-Thuaj). Është jashtë logjike që një njeri i

ngarkuar me misionin e udhëzimit, edukimit e pastrimit shpirtëror, të jetë tradhtar, gjynahqar dhe i shthurur, të urdhërojë të tjerët në të mira dhe vetë të mos i bëjë të mirat, apo t'i ndalojë të tjerët nga e keqja dhe vetë ai ta bëjë të keqen.

2- Allahu është Një, i Vetëm, i Pashoq. Në ajetin 22 të sures “Enbija” thuhet:

لَوْ كَانَ فِيهِمَا آلَاءُ اللَّهِ إِلَّا اللَّهُ لَفَسَدَتَا فَسُبْحَانَ اللَّهِ رَبِّ الْعَرْشِ عَمَّا يَصِفُونَ

“Sikur në qiej dhe në Tokë të kishte zota të tjerë, përveç Allahut, si qiejt, ashtu edhe Toka do të shkatërroheshin. Qoftë i lavdëruar Allahu, Zoti i Arshit dhe i lartësuar mbi çka i përshekruajnë Atij!”

Çdo gjë në këtë ekzistencë dëshmon se nuk ka zot tjetër, përveç Allahut. Në ajetin 53 të sures “Fussilet” thuhet: **“Ne do t’u tregojmë atyre Shenjat Tona në hapësirat tokësore e qiellore, si dhe në vetat e tyre, derisa t’u bëhet plotësisht e qartë se Ai është e Vërteta...”**

3- Allahu është gjithmonë me ne (*ue huue makum ejne ma kuntum*), ajeti 4, Sure “Hadid”) edhe pse nuk e shohin sytë tanë. Në suren “En’am”, ajeti 103 thuhet:

لَا تُدْرِكُهُ الْأَبْصَارُ وَهُوَ يُدْرِكُ الْأَبْصَارَ وَهُوَ اللَّطِيفُ الْخَبِيرُ

“Shikimet njerëzore nuk mund ta arrijnë Atë, ndërkohë që Ai i arrin shikimet e të gjithëve. Ai është Bamirës i Pakufi dhe di gjithçka.”

4- Allahu është Një në çdo gjë: në Qenie, në Atribute, në Dije, në Jetë, në Fuqi.

5- T'i drejtohem Allahut për gjithçka dhe t'i mbështetemi Atij! Të gjitha krijesat ia kanë nevojën Krijuesit. Vetëm Allahu e meriton që t'i drejtohem. *(Ijake na'bud ue ijake nesteijn.)*

6- Ai është i Pasuri i vërtetë dhe Absolut dhe gjithçka, përveç Tij është nevojtar. Në suren “Fatir” ajeti 15 thuhet:

يَا أَيُّهَا النَّاسُ أَنْتُمُ الْفُقَرَاءُ إِلَى اللَّهِ وَاللَّهُ هُوَ الْغَنِيُّ الْحَمِيدُ

“O njerëz! Ju jeni të varfër e nevojtarë për Allahun, kurse Allahu s'ka nevojë për asgjë dhe është i Denjë për çdo lavd.”

7- Pyetjeve u duhet dhënë përgjigje.

8- Meqenëse Allahu është Ai që i drejtohen dhe i mbështeten krijesat dhe përderisa Ai është i Vetmjaftueshëm, kjo tregon se Ai nuk ka nevojë as për fëmijë e as për prindër dhe nuk është i lindur nga askush e nuk ka lindur askënd. Në ajetin 111 të sures “Isra” thuhet:

وَقُلِ الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي لَمْ يَتَّخِذْ وَلَدًا وَلَمْ يَكُنْ لَهُ شَرِيكٌ فِي الْمَلِكِ وَلَمْ يَكُنْ لَهُ وِئَاتٌ مِنَ الْأَدْلِ وَ
كِبْرُهُ تَكْبِيرًا

“Thuaj: ‘Çdo lavd e falënderim i përket Allahut, i Cili nuk ka fëmijë, nuk ka ortak në pushtet dhe nuk është i pafuqishëm, që të ketë nevojë për ndihmës. Madhëroje Atë, duke ngritur lart madhështinë Tij!’”

Ndërsa në ajetin 3 të sures “Xhin” thuhet:

وَأَنَّهُ تَعَالَى جَدُّ رَبِّنَا مَا اتَّخَذَ صَاحِبَةً وَلَا وَلَدًا

“Qoftë lartësuar Madhëria e Zotit tonë! Ai nuk ka zgjedhur as bashkëshorte, as fëmijë.”

9- I linduri nuk mund të jetë kurrë Zot, Krijues.

10- Askush dhe asgjë nuk i ngjason Allahut. Në ajetin 11 të sures “Shura” thuhet:

لَيْسَ كَمِثْلِهِ شَيْءٌ وَهُوَ السَّمِيعُ الْبَصِيرُ

“Asgjë nuk i shëmbëllet Atij. Ai i dëgjon të gjitha dhe i sheh të gjitha.”

Në ligjëratën 286, në *Nehxhul Belaga*, imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) thotë: “Ai nuk ka lindur kënd, që të jetë edhe Vetë i lindur. Nuk është i lindur prej askujt, që të jetë i kufizuar. Nuk ka të ngjashëm me Të, që të krahasohet me kënd...”.

MËSIMET NGA AJETET E SURES “FELEK”

Në suren “Ibrahim”, ajeti 1, Allahu i Madhëruar thotë:

الرَّكِيْبَاتُ أَنْزَلْنَاهُ إِلَيْكَ لِتُخْرِجَ النَّاسَ مِنَ الظُّلُمَاتِ إِلَى النُّورِ بِإِذْنِ رَبِّهِمْ إِلَى صِرَاطٍ الْعَزِيزِ الْحَمِيدِ

“Elif Lâm Râ. Këtë Libër ta kemi shpallur ty (o Muhamed), për t’i nxjerrë njerëzit, me lejen e Zotit të tyre, nga errësira në dritë, në rrugën e të Plotfuqishmit, të Denjit për çdo lavd.”

Një prej qëllimeve të zbritjes së Kur'anit është nxjerrja e njerëzve nga errësirat në dritë. Kur'ani është madhështor. Themi se është madhështor sepse e ka dërguar Krijuesi Madhështor, Allahu Fuqiplotë me ndërmjetësimin e melekut më të madh, Xhebrail Emijni (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe ia shpalli njeriut madhështor në këtë gjithësi, të dashurit të Tij, Profetit Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), me të cilin e vulosi profetësinë.

Surja Felek është Surja e 113-të e Kur'anit. Ka 5 ajete.

Në këtë sure Allahu thotë:

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ الْفَلَقِ مِنْ شَرِّ مَا خَلَقَ وَمِنْ شَرِّ غَاسِقٍ إِذَا وَقَبَ وَمِنْ شَرِّ النَّفَّاثَاتِ
فِي الْعُقَدِ وَمِنْ شَرِّ حَاسِدٍ إِذَا حَسَدَ

1. Me Emrin e All'Ilahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit
2. Thuaj: 'Kërkoj mbështetje te Zoti i agimit,
3. që të më mbrojë nga sherri i gjithçkaje që Ai ka krijuar;
4. Dhe nga sherri i natës, kur kaplon terri;
5. Dhe nga sherri i falltarëve, që fryjnë në nyja (duke bërë magji);
6. Dhe nga sherri i smirëziut, kur vepron me smirë."

Mirësia e leximit të sures "Felek"

Profeti Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) i tha njërit prej shokëve të tij: "A dëshiron të të mësoj dy sure, të cilat janë më të mirat e Kur'anit?" Po, o i Dërguar i Zotit! Hazreti Muhamedi i mësoi atij suret Muauedhetjen (suren "Felek" dhe suren "Nas"). Më pas i këndoi ato dy sure në namazin e agimit dhe i tha përsëri shokut:

“Kurdoherë që ngrihesh nga shtrati dhe kur të biesh në shtrat, këndoji këto dy sure.”

NGA KJO SURE MËSOJMË:

1- Në ajetin e parë të kësaj sureje, Profet Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) urdhërohet të mbështetet te Zoti i agimit prej të gjitha sherreve të të gjitha krijesave. Edhe pse kjo sure i drejtohet Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), urdhri është për të gjithë ne që të kërkojmë ndihmën dhe mbrojtjen e Allahut nga çdo e keqe.

2- E keqja (sherri) vjen kur krijesat largohen nga rruga e Allahut dhe njerëzit ndjekin rrugën e shejtanit të mallkuar.

3- Surja flet për tri lloje sherresh: 1. Sherri i sulmuesve të natës, të cilët përfitojnë prej errësirës dhe sulmojnë. 2. Sherri i falltarëve, që me fjalët dhe me propagandën e tyre duan të marrin për vete vullnetin, besimin e të tjerëve. 3. Sherri i smirakut.

4- Në pamje të jashtme shumë gjëra, konsiderohen si të këqija, por brenda tyre janë për mirë, për shembull ndodhitë që na paralajmërojnë, na zgjojnë nga gjumi i

shkujdesjes. Në ajetin 216 të sures Bekare Allahu i Madhëruar thotë:

وَعَسَىٰ أَنْ تَكْرَهُوا شَيْئًا وَهُوَ خَيْرٌ لَّكُمْ وَعَسَىٰ أَنْ تُحِبُّوا شَيْئًا وَهُوَ شَرٌّ لَّكُمْ وَاللَّهُ يَعْلَمُ وَأَنْتُمْ لَا تَعْلَمُونَ

“...Por mund ta urreni një gjë, ndërkohë që ajo është e mirë për ju e mund ta doni një gjë, ndërkohë që ajo është e dëmshme për ju. Allahu di, kurse ju nuk dini.”

5- Keqbërësi përfiton nga errësira e natës për të sulmuar. Dhe, jo vetëm kafshët e egra dalin natën nga strofka e tyre dhe sjellin ligësi; dalin edhe njerëz keqdashës e keqbërës dhe e përdorin natën për qëllime të këqija.

6- Gjithmonë duhet t'i kërkojmë mbështetje Allahut dhe të themi: *I kërkoj mbrojtje Allahut nga kjo e kjo*. Në ajetin 97 dhe 98 të sures Mu'minun thuhet: **“Dhe thuaj: ‘O Zoti im, kërkoj të më mbrosh nga nxitjet e djajve.’ Dhe tek Ti mbështetem, o Zoti im, që të mos i kem pranë meje.”**

7- Të gjithë i kërkojnë mbrojtje Allahut. Madje edhe profetët (*Paqja qoftë mbi ta!*) i kanë kërkuar mbrojtje Allahut. Në fillim të kësaj sureje, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i All'Ilahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) urdhërohet t'i kërkojë mbrojtje Allahut prej të gjitha të këqijave të të gjitha llojeve të krijesave.

8- Nuk mund të arrihet ndreqja e vetes, e familjes dhe e shoqërisë pa i kërkuar ndihmë dhe mbrojtje Allahut Fuqiplotë.

9- Të këqijat bëjnë punën e drynit në zemrën dhe në mendjen e njeriut. Prandaj, duhet kërkuar ndihmë e mbrojtje te Fuqia, që i hap dhe i shkatërron këta dryna dhe ajo është fuqia absolute e Allahut.

10- Lutjet tona të mos kufizohen për një çështje, por të jenë përgjithësuese: Të lutemi për mbrojtje nga gjithçka e keqe, të lutemi edhe për të tjerët.

11- Ndër të gjitha sherret, smira është një nga më të këqijat. Kur'ani e ka rreshtuar atë tek të këqijat e kafshëve të egra, të gjarpërinjve helmues dhe të shejtanit të mallkuar.

12- Një ndër shkaqet e smirës, është besimi i dobët. Janë edhe koprracia dhe mendja e ngushtë. Smira do largimin e mirësisë nga të tjerët. Në ajetin 54 të sures "En Nisa" Allahu thotë: **"A mos i kanë zili njerëzit për çfarë u ka dhuruar Allahu nga të mirat e Veta?"** Smira është burim i shumë gjynaheve të mëdha. Smira, ashtu sikurse është cilësuar edhe në hadithe, e ha besimin e njeriut dhe e zhduk fare atë. Në një hadith të imam Sadikut (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*) thuhet: *"Dobësuesit e besimit janë smira, mendjemadhësia dhe mburrja."*

13- Smiraku i del kundër urtësisë dhe vendimit të Zotit sepse mendon e thotë: Përse Zoti u ka falur disave mirësi dhe i ke përfshirë nën kujdesin e Tij. Smiraku gjithmonë ka qenë pengesë e rrugës së profetëve. Prandaj edhe Kur'ani i Shenjtë e urdhëron Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) që të kërkojë mbrojtjen e Zotit prej sherrit të smirakut.

Për të parë se sa e ligë është smira, mjafton t'i hedhim një sy vrasjes së parë që ndodhi midis dy vëllezërve: Kabili e vret Habilin nga smira.

14- Për smirën nuk ka ilaç tjetër përveç kërkimit të mbrojtjes nga Allahu.

MËSIMET NGA AJETET E SURES “NAS”

Sipas renditjes së tubimit të Kur'anit, “En Nas” është surja e 114-të; sipas zbritjes është surja e 20-të. Ka zbritur pas sures “Felek” dhe para sures “Ikhlâs”. Surja “Nas” ka 6 ajete.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ النَّاسِ
مَلِكِ النَّاسِ إِلَهِ النَّاسِ مِنْ شَرِّ الْوَسْوَاسِ الْخَنَّاسِ الَّذِي يُوَسْوِسُ

فِي صُدُورِ النَّاسِ مِنَ الْجِنَّةِ وَالنَّاسِ

1. Me Emrin e All'Ilahut, të Gjithëmëshirshmit,
Mëshirëplotit
2. Thuaj: ‘Kërkoj mbështetje te Zoti i njerëzve,
3. Sundimtari i njerëzve,
4. i Adhuruari (i vetëm me të drejtë) i njerëzve,
5. nga sherri i djallit cytës që fshihet (pasi cyt),

6. e që hedh dyshime në zemrat e njerëzve.

7. (Qoftë ai djall) prej xhindeve apo njerëzve!

Përmbajtja e sures, është e ngjashme me suren “El Felek”. Që të dyja këshillojnë që të mbështetmi tek Allahu prej të këqijave, me ndryshimin që në suren “El Felek” janë përmendur shumë lloje cytjesh dhe sherresh, ndërsa në suren “En Nâs” është folur më shumë për sherrin e cytjeve që nuk duken.

Mirësitë e leximit të sures “En Nâs”

Janë transmetuar shumë hadithe për mirësitë e leximit të sures “En Nâs”. Po përmendim një hadith: Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) qe sëmure rëndë. Xhibraili dhe Mikaili i qenë ulur pranë. Njëri i rrinte te koka (Xhibraili), kurse tjetri (Mikaili) te këmbët. Xhibraili i këndoi suren “El Felek” dhe kërkoi mbrojtjen e Zotit nëpërmjet saj, ndërsa Mikaili i këndoi suren “En Nas”.⁴⁸

Në një transmetim të imam Bakirit (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*) lexojmë: “Kujtdo që këndon suren ‘El Felek’ dhe ‘En Nâs’

⁴⁸ Tefsiri “Nuruth Thekalejn”, vëll. 5, f. 7645; Tefsiri “Mexhmaul Bejan”, vëll. 10, f. 569.

*në namazin e vitrit, i thuhet: 'O rob i Zotit! Ty të është pranuar namazi.'"*⁴⁹

NGA KJO SURE MËSOJMË:

1- Fjala "kul", (Thuaj), përmendet më shumë se 300 herë në Kur'an dhe në të shumtën e përmendjeve është urdhër për Profetin. Por, ashtu, është urdhër edhe për ne.

2- Nuk mjafton vetëm thënia "kërkoj mbrojtje" për të shpëtuar nga e keqja dhe nga rreziku, por duhet larguar nga shkaqet e rrezikut e të së keqes. Të ndërtosh shtëpinë buzë lumit dhe të shënosh mbi derë "i kërkoj mbrojtje Allahut nga përmbytja", është qesharake.

3- Mbrojtja i kërkohet Allahut, që i di të fshehtat dhe askujt tjetër, përveç Allahut sepse nuk është i tillë siç, thotë ajeti 19 i sures "Gafir": **"Allahu e di shikimin e përvjedhur të syrit dhe atë që fsheh zemra."**

4- Pëshpëritja në vesh të të tjerëve për të hedhur tek ata dyshime, është vepër djallëzore.

⁴⁹ Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 7645; Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 569.

5- Kur'ani fillon me *Bismilah* (Me emrin e Allahut) dhe përfundon me (Mbrotjtje nga njerëzit)

6- Allahu është Edukuesi i njerëzve. Prandaj nuk duhet të ndjekim rrugët e të tjerëve, por vetëm Rrugën e Allahut. Allahu është Sunduesi i njerëzve, prandaj nuk duhet të jemi rob të të tjerëve. Allahu është i Adhuruari më i denjë, prandaj duhet të shpresojmë veçse tek Ai. Kjo është mënyra më e mirë për të kërkuar ndihmë.

7- Përsëritja e fjalës *nas* në këtë Sure tregon se sundimi i Allahut është për të gjithë njerëzit, Ai është Zoti i të gjithë njerëzve dhe të gjithë njerëzit duhet ta adhurojnë Atë.

8- Vërtet, Allahu i di të gjitha nevojat e njerëzve. Mirëpo, Allahu na ka mësuar dhe na ka urdhëruar që njeriu të pohojë me gjuhën e tij se është nevojtar i pafuqishëm. Me anë të këtij pohimi në vetë qenien e tij do të lulëzojë thjeshtësia, përrulja dhe bindja.

9- Profeti është besnik i Shpalljes dhe nuk thotë asgjë nga vetja e tij, siç thuhet në suren "Nexhm": "**Ai nuk flet sipas qejfit të vet, por ajo (që thotë) është vetëm Shpallje hyjnore, që i vjen atij. Atë ia ka mësuar atij një (melek) shumë i fuqishëm (Xhebraili).**"⁵⁰

⁵⁰ Sure "Nexhm", ajetet 3-5.

10- Kur rreziqet janë të mëdha, Allahu e urdhëron Profetin që të kërkojë mbrojtje.

11- Të këqijat nuk mund të luftohen pa i kërkuar mbrojtje Allahut.

12- Gjynahqarët nuk duhet të bëhen pesimistë sepse Allahu është Zoti i të gjithë njerëzve dhe jo vetëm i besimtarëve. Në ajetin 53 të sures "Zumer" thuhet: **"Thuaj: 'O robtë e Mi, që i keni bërë keq vetes me gjynahe, mos e humbni shpresën në Mëshirën e Allahut! Allahu, me siguri, i fal të gjitha gjynahet (përvese t'i bëhet shok Zotit). Vërtet, Ai është Falësi i madh dhe Mëshirëploti."**

13- Kjo Sure e urdhëron Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i All'Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), si udhëheqës dhe drejtues i fesë islame të kërkojë mbrojtje nga sherri i cytësit. Përderisa Profeti lutej dhe i kërkonte mbrojtje Allahut, atëherë detyra jonë është shumë e qartë: Edhe ne të lutemi Allahut dhe të kërkojmë mbrojtje nga Allahu.

14- Njeriu duhet të pranojë sundimin absolut të Allahut dhe ta adhurojë Allahun derisa t'i vijë vdekja, siç thotë ajeti 99 i sures "Hixhr": **"Dhe adhuroje Zotin tënd derisa të të vijë vdekja!"**

15- Besimtari strehohet tek Allahu i Plotfuqishëm e i Gjithëditur, ndërsa jobesimtari strehohet te padronët e tij - te pasuria e tij etj.

16- Njeriu është gjithmonë në shënjestër të shejtanit. Shejtani, xhind dhe njerëz, përpiqen të ndikojnë në zemrën dhe shpirtin e tij. Sa më shumë të rritet pozita e njeriut në shoqëri, aq më të shumta do të jenë edhe vesveset dhe cytjet e shejtanit, që ta largojnë atë nga Rruga e Drejtë dhe ta prishë botën me shthurje e korrupsion.

17- Kur themi "*Rab'bi'n Nas*" (Zoti i njerëzve), ne kemi dëshmuar për sundimin e Zotit dhe veten tonë e kemi vendosur nën edukimin e Tij. Kur themi "*Maliki'n Nas*" (Sundimtari i njerëzve), veten tonë e dimë pronë të Zotit dhe robi i bindet urdhrin të Tij. Kur themi "*Ilahi'n Nas*" (I Adhuruari (i vetëm me të drejtë) i njerëzve), do të thotë se ecim në Rrugën e Zotit dhe nuk adhurojmë askënd e asgjë tjetër përveç Atij. Pa dyshim, ai besimtar që i përsërit gjithmonë këto thënie, do të jetë i mbrojtur prej sherrit të cytësve.

Shejtanët e kryejnë fshehurazi punën dhe planin e tyre. Ata aq shumë i fryjnë njeriut në vesh, sa që njeriu u beson atyre dhe mendon se fjala e tyre është e tij. Brenda tij, shpirti i vlon. Kjo gjë bëhet shkak që ai të humbasë dhe të ndjekë rrugë të gabuar. Prandaj është e domosdoshme të mbështetemi tek Allahu dhe të kërkojmë mbrojtje prej Tij.

Shejtani mashtron me cytjet e tij, duke e larguar njeriun prej së vërtetës dhe duke e bërë të vërtetën gënjeshtër. Mëkatin e fsheh në rrobën e adhurimit. Paudhësinë - në rrobën e udhëzimit.

Vetë shejtanët janë të fshehur. Edhe veprat, edhe veprimet edhe planet e shejtanëve janë të fshehura. Kjo për ne është paralajmërim, që të mos mendojmë se shejtani do të na dalë ne përpara me fytyrën e tij të vërtetë, apo se do t'i shohim me sy planet e tij. Nuk do jetë kurrë kështu. Ata do të na cytin me vesvese me gënjeshtër, me hile, me dredhi.

Na shtyjnë në të keqe edhe miqtë jo të mirë, edhe të devijuarit, edhe udhëheqësit e tiranë, edhe shkrimtarë e titullarë të shthurur, edhe shkollat, që nga pamja e jashtme të mashtrojnë, edhe mjetet masive të komunikimit etj. Prandaj njeriu duhet të mbështetet tek Allahu dhe të kërkojë mbrojtje për të gjitha tek Allahu.

Të mbështetemi tek Allahu, duke u ruajtur prej rrugëve, planeve, kurtheve, punëve, fjalëve etj të shejtanit. Të mbështetemi tek Allahu edhe duke u larguar nga ato vende që shejtani i ka shumë qejf. Të mbështetemi tek Allahu duke e vënë veten tonë në Rrugën e Mëshiruesit dhe të bëjmë vepra me të cilat Ai është i kënaqur. Nëse nuk bëjmë këto, do ta vendosim veten tonë para një tufani vesvesesh. Largimi nga ky tufan nuk arrihet vetëm me këndimin e fjalëve të kësaj sureje, por edhe duke punuar si më lart.

Allahu na e ndriçoftë zemrën me dritën e Kur'anit! Allahu na dhuroftë shefatin e Kur'anit!

دروس من قصار السور القرآن

تيرانا 2024

اسم الكتاب: دروس من قصار السور القرآن

المؤلف: الحاج الشيخ ولنت مريا

التصحيح الأدبي: پروفيسور دكتور خيرى شهو

التصحيح اللغوي: ويولسا كاراي

الاخراج النهائي و تصميم الغلاف: صبريه فزا

ناشر: موسسه قرآن - تيرانا - ألبانيا